



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e teknologjisë së informacionit ushtruar në
Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË DREJTIM TË KUNDRAVAJTJEVE RRUGORE

NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë, Maj 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit	4
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi	5
2.	Identifikimi i çështjes	5
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5
4.	Përgjegjësitë e audituesve	5
5.	Kriteret e vlerësimit	6
6.	Standardet e auditimit	6
7.	Metodat e auditimit	6
8.	Dokumentimi i auditimit	6
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	7
2.1	Auditimi i Sigurisë së Informacionit për sistemin e Kundravajtjeve Rrugore	7-15
a	Rruajtja e të dhënave, vazhdimësia e ofrimit të shërbimit, identifikimi i risqeve.	
b	Menaxhimi i ndryshimeve në proceset e informatizuara.	
c	Përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si dhe të drejtat e tyre.	
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	15-29
a	Investimet në drejtim të teknologjisë së informacionit.	
b	Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.	
2.3	Auditimi i sistemit informatik të Kundravajtjeve Rrugore mbi të dhënat Input / Output	29-37
IV.	REKOMANDIME	37-45

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore, nga data 22.01.2024 deri në 29.03.2024.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në DPPSH, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-ës.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore në DPPSH, si dhe në rastet kur vetë institucioni ka qenë përfitues shërbimi për kontrata që janë lidhur nga AKSHI.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1139/1, me datë 18.01.2024.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga auditimi mbi procesverbalet e konstatimit të shkeljes, u konstatua se fotografimi nuk është bërë pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, miratuar me VKM nr. 42, datë 30.01.2019. Fotografia është prova që vërteton shkeljen e konstatuar. Mungesa e kësaj prove në informacionin që i vihet në dispozicion kundërvajtësit nëpërmjet shërbimeve online në eAlbania, bën që të ketë një numër të lartë ankesash në këtë drejtim.

- Në strukturën e miratuar për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit nga një numër total prej 102 punonjësish aktualisht janë 32 pozicione vakante. Strukturat me më shumë vakanca janë Drejtoria e Sistemeve, Qendra Operative e Sigurisë dhe Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave

- Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, u konstatua se dokumentet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në disa raste mungojnë e në disa raste janë nënshkruar në grup për 2 apo 3 muaj shërbim mirëmbajtje njëkohësisht, çfarë tregon për një vijimësi formale në ndjekjen e zbatimit të kontratës. Nuk janë raportuar problematika në lidhje me sistemin e Gjopa duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë problematikë, megjithëse vetë agjentët e policisë u shprehën se deri në fund të vitit 2023 sistemi ka shfaqur probleme të vazhdueshme.

- Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjopa, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, u konstatua se nuk janë plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara mbi raportimin. Nga auditimi mbi funksionet shitesë të parashikuara në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se disa nga kërkesat e specifikimeve teknike **nuk janë realizuar**.

- Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për sistemin eGjopa, u konstatua se nuk janë përcaktuar rregullat mbi administrimin e të dhënave dhe nivelet e aksesimit për të gjithë palët që kanë akses mbi to në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ku DPPSH është krijuar, zotëruar dhe administrues, ndërsa AKSHI është ofrues i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe sistemit informatik të cilat aktualisht i ka kontraktuar tek Operatori Ekonomik.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për shtimin e fotos së kundravajtjes për mjetin e konstatuar pa prezencë të shkelësit e cila aktualisht nuk është pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, me qëllim minimizimin e ankesave, minimizimin e kohës së trajtimit dhe përgjigjes së tyre, nisur nga fakti që fotografimi i shkeljes është një nga provat që vërteton kundravajtjen.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm me punonjës të fushës së Teknologjisë së Informacionit.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, në mungesë të punonjësve që kanë vepruar si ndjekës të kontratave të sistemit eGjoba, të ngrejë një grup specialistësh me qëllim verifikimin e çështjeve që nuk janë realizuar në kontratën e parë nga OE, i cili është aktualisht i kontraktuar për kontratën aktuale. Mangësitë të përcillen tek AKSHI si Autoritet Kontraktues për sistemin eGjoba dhe përmirësimin e tij.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI si Autoritet Kontraktues, mangësitë në zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit eGjoba në zbatim të kontratës nr.20, datë 16.08.2022, të cilat jo vetëm nuk janë realizuar, por kanë penguar veprimet operacionale të nevojshme për Drejtorinë e Policisë Rrugore Drejtorisë së Policisë Rrugore.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si institucion krijues dhe administrues i të dhënave që ruhen në sistemin eGjoba, të marrë masa për hartimin e procedurave, organizimin dhe funksionimin e brendshëm si dhe përcaktimin e niveleve të aksesimit në këto të dhëna, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vlerësojmë se sistemi informatik i ndërtuar me qëllim verbalizimin dhe administrimin e të dhënave mbi Kundravajtjet Rrugore, ka mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij. Me ndërtimin e këtij sistemi, nuk është arritur të shmanget plotësisht letra nga veprimtaria operacionale e Drejtorisë së Policisë Rrugore.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dy institucionet kryesore që kanë rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimit të këtij informatizimi, nevojitet të analizojnë dhe të veprojnë mbi shkaqet që kanë penguar maksimizimin e proceseve të informatizuara në eGjoba.

Dy institucionet nevojitet të dakortësojnë gjithashtu mbi rolet e tyre në këtë informatizim, në mënyrë që të sigurohet angazhimi në përmirësimin dhe monitorimin e zhvillimit të këtij sistemi.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 1139/1 prot., datë 18.01.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.01.2024 deri më datë 29.03.2024, në subjektin “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit në drejtim të kundravajtjeve rrugore, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. D. B., auditues;
3. A. K., audituese.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në DPPSH, nga data 22.01.2024 deri më datë 29.03.2024. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e institucionit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT në funksion të Kundravajtjeve Rrugore, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e informacionit që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve që i shërbejnë Kundravajtjeve Rrugore.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1139/1 Prot, datë 18.01.2024:

1. Auditimi i Sigurisë së Informacionit për sistemin e Kundravajtjeve Rrugore
 - a. Rruajtja e të dhënave, vazhdimësia e ofrimit të shërbimit, identifikimi i risqeve.
 - b. Menaxhimi i ndryshimeve në proceset e informatizuara.
 - c. Përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si dhe të drejtat e tyre.
2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit
 - a. Investimet në teknologjinë e informacionit.
 - b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.
3. Auditimi i sistemit informatik të Kundravajtjeve Rrugore mbi të dhënat Input / Output.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Në drejtim të kundravajtjeve rrugore, që është dhe objekti specifik i këtij auditimi IT, Policia e Shtetit mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislationin rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është struktura qendrore administrative dhe teknike e Policisë së Shtetit, që organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel drejtorie të përgjithshme, drejtorie dhe sektori. Drejtoria Vendore e Policisë është strukturë administrative e Policisë në nivel vendor, që organizohet në struktura organizative hierarkike drejtorie, sektori, komisariati, seksioni, stacioni dhe posta policie.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi DPPSH mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 29.03.2024, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që lidhen me Kundravajtjet Rrugore, zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së Kodit Rrugor nëpërmjet sistemit informatik eGjoha.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr.1139/1 Prot., datë 18.01.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislationin e fushës në të cilën operon DPPSH në drejtim të kundravajtjeve rrugore si dhe legjislationi për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”;
- Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Ligj nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM nr.945, datë 2.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;
- VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, etj;
- Vendim nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”;
- Rregulloret e miratuara nga CESK;
- Standardet TIK, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit, të AKSHI-t si dhe të AKCESK;
- Shqyrtimi i dokumenteve ligjorë të nënshkruar nga AKSHI, për sistemin informatik eGjoba;
- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Dokumentacioni i arkivuar i dosjeve të prokurimit, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, testime dhe raporte të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Në përputhje me Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Policia e Shtetit ka si objekt të saj ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Policia e Shtetit është e centralizuar dhe e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përfaqëson nivelin qendror dhe drejtoritë vendore nivelin vendor të policisë. Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit janë sipas qarqeve: DVP Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Kukës, Dibër, Berat.

Drejtori i Policisë së Shtetit është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ e operacional i policisë dhe përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për realizimin e politikave, performancës dhe objektivave të përcaktuara.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit është struktura e IT, nën varësi të DPPSH. Misioni i saj është përmirësimi i mëtejshëm i institucionit nëpërmjet rritjes cilësore të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Menaxhimi i projekteve/sistemeve të teknologjisë së informacionit sjell realizimin e prioriteteve strategjike të Policisë së Shtetit si: informatizimi i proceseve të punës, përmirësimi i menaxhimit të informacionit, si dhe rritja e cilësisë së shërbimit në strukturat e Policisë së Shtetit.

Infrastruktura e teknologjisë së informacionit ku përfshihen jo vetëm pajisjet fizike servera, router etj, por dhe sistemet informatike që janë ndërtuar në vite dhe janë funksionale aktualisht, ndodhen fizikisht dhe në regjistrin e aseteve të DPPSH-së.

Kontrata e shërbimit, implementimit dhe mirëmbajtjes së sistemit “egjoba” është zhvilluar nga AKSHI, i cili është dhe Autoriteti Kontraktor, ndërsa për ndjekjen dhe zbatimin e tyre janë ngritur grupe të përbashkëta ndërmjet AK dhe institucionit përfitues që është DPPSH.


2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i Sigurisë së Informacionit për sistemin e Kundravajtjeve Rrugore

Për kryerjen e funksioneve institucionale Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër nr. 688 datë 10.05.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, e cila është e ndërtuar mbi bazën e Drejtorive dhe Sektorëve. Veprimtaria e tyre rregullohet nëpërmjet përshkrimeve të punës miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1509 datë 25.10.2023.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është gjithsej 11932 punonjës nga të cilët 102 punonjës i përkasin Departamentit për Teknologjinë e Informacionit.

Figura nr.1: Struktura e Departamentit për Teknologjinë e Informacionit



Burimi: DPPSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në DPPSH është i përbërë në strukturë nga Drejtori i Departamentit i cili ka në varësi 1 asistent. Ky departament ka në varësi tre drejtori dhe një sektor:

1. Drejtoria e Sistemeve e përbërë nga 51 punonjës nga të cilët 17 vakanca;
2. Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave e përbërë nga 13 punonjës nga të cilët 10 vakanca;
3. Drejtoria e Infrastrukturës e përbërë nga 29 punonjës nga të cilët 5 vakanca;
4. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse i përbërë nga 7 punonjës përkatësisht 1 shef sektori, 1 specialist logjistike, 1 specialist personel (sekretari-Arkive), 3 specialist për trajnimet e TI si dhe 1 kujdestar - magazinier (për armatimin dhe të tjera).

Tabela nr. 1: Struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Plan/Fakt

Nr.	Emërtimi	Numër viti 2024	
		Plan	Fakt
1	Drejtor	1	1
2	Asistent	1	1
I. Drejtoria e Sistemeve			
1	Drejtor	1	1
Sektori i Sistemeve dhe BCC			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	6	5
Sektori i Sigurisë së Informacionit			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	4	2
Sektori i Hartimit të Projekteve			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	2	2
Sektori i Helpdesk			
1	Shef sektori	1	1
2	Specialist	17	13

3	Teknik i mesëm TI	1	1
Qendra Operative e sigurisë (SOC)			
1	Shef i Qendrës	1	1
2	Specialist	15	8
II. Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave			
1	Drejtor	1	0
Sektori i Programimit dhe Zhvillimit			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	3	1
Sektori i Bazave të të Dhënave			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	4	1
Sektori Administrimit të Aplikacioneve dhe DevOPS			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	2	1
III. Drejtoria e Infrastrukturës			
1	Drejtor	1	1
Sektori i administrimit të rrjetave dhe komunikimeve			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	7	7
3	Trup shërbimi/Dajt	5	5
Sektori i teknologjive monitoruese dhe telefonike			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	5	3
3	Teknik i mesëm TI	1	1
Sektori i Infrastrukturës			
1	Shef sektori	1	0
2	Specialist	4	4
3	Teknik i mesëm TI	3	3
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse			
1	Shef sektori	1	1
2	Specialist logjistike	1	1
3	Specialist personal (sekretari-Arkive)	1	1
4	Specialist për trajnimet e T.I.	3	3
5	Kujdestar – magazinier (për armatimin dhe të tjera)	1	1
Total		102	70

Burimi: DPPSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, në strukturën e miratuar për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit nga një numër total prej 102 punonjësish aktualisht janë 32 pozicione vakante. Strukturat me më shumë vakanca janë Drejtoria e Sistemeve, Qendra Operative e Sigurisë dhe Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave.

❖ **Auditi i Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

Misioni i njësisë së auditimit të brendshëm është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur dhe profesionale duke dhënë garanci të arsyeshme, për eficientësinë, efektivitetin dhe ekonomikitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.

Struktura aktuale e funksionimit të Auditit të Brendshëm është miratuar nga ministri i brendshëm me Urdhër nr. 47 datë 14.04.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit” protokolluar nga Ministria e Brendshme me nr. 4191/1 prot., datë 14.04.2023 dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me nr. 2915/2 prot., datë 14.04.2023.

Bazuar në strukturën e DPPSH në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka të miratuar një numër prej 5 punonjësish. AB ushtron aktivitetin nga 1-Shef Sektori, 2- Specialist dhe 2-Inspektor nga të cilët asnjë prej tyre nuk është i profilit të teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar ku citohet se:

✓ Neni 4/pika 6 - “Auditimi i teknologjisë së informacionit” përfshin vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike;

✓ Neni 9/pika 1 - Një angazhim auditimi për shërbimet e sigurisë përfshin një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit të një njësie të sektorit publik, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, auditimit të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit dhe lloje të tjera të auditimit të brendshëm.

Si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave. Kartën e auditimit, Kodin Etik për audituesin e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera për kryerjen e auditimit.

Nga auditimi u konstatua se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit.

- Audituesit e strukturës së Auditit të Brendshëm kanë zhvilluar auditime në drejtim të teknologjisë së informacionit por me objektiv të kufizuar për asrye të mungesës në strukturë të specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit. Specialistët e fushës për auditimet që ata kanë zhvilluar i kanë marrë përkohësisht nga struktura e teknologjisë së informacionit në DPPSH duke u siguruar që mos të jenë në konflikt me procesin që është objekt auditimi, përësëri jemi në mospërputhje me kriteret e punësimit të audituesit të brendshëm përcaktuar sipas nenit 11 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

1.a Ruajtja e të dhënave, vazhdimësia e ofrimit të shërbimit, identifikimi i risqeve

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhornimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar se ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Institucionit. Vazhdueshmëria e biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Për këtë pikë grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion Manuali “Për vazhdueshmërinë e punës, në rastet e ndodhjes së një incidenti, ndërprerje të shërbimeve apo fatkeqësive” miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1238 datë 31.08.2023, i cili ka për qëllim përcaktimin e masave dhe veprimeve organizative dhe funksionale që aplikohen dhe implementohen paraprakisht për të mbrojtur personelin, të dhënat dhe asetet teknologjike të Policisë së Shtetit.

Në zbatim të këtij manuali duhet të hartohet dhe Strategjia e Backup e dedikuar dhe Strategjia e Rikuperimit e dedikuar. Kjo strategji apo plan backup-i sipas këtij manuali do të mundësojë ruajtjen e elementëve kritikë për vazhdueshmërinë e punës dhe të operacioneve në rast të incidenteve apo fatkeqësive. Gjithashtu në të përcaktohet se kjo politikë përcakton se për çdo sistem do të hartohet e dokumentohet Analiza e Impaktit në Punë bazuar në të cilën, për secilin sistem apo shërbim do të hartohen dy dokumentet e sipërpërmendur. Gjithshtu bazuar në Analizën e Impaktit në Punë do të parashikohet periodiciteti dhe afati i kryerjes së testeve mbi efektivitetin e backup-eve dhe aftësisë për rikuperim.

Nga auditimi u konstatua se, për sistemin eGjopa nuk është hartuar dhe dokumentuar Strategjia e Backup e dedikuar dhe Strategjia e Rikuperimit e dedikuar me elementët që duhet të përfshihen sipas këtij manuali.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet procesi i hartimit të planit të testimave, i realizimit të testimave dhe i rezultateve të dala nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike, si dhe ruajtja e kopjes rezervë në një tjetër ambient.

Nga auditimi u konstatua se, DTI nuk ka ngritur Qendrën e Vazhdueshmërisë së Punës në një vendodhje gjeografike të distancuar nga qendra primare e të dhënave.

➤ Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme.

Me shkresën Nr. 294/1 Prot., datë 11.02.2022 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit “Për dërgim të pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2021”, në të cilin përfshihet edhe regjistri i riskut për vitin 2022. Me shkresën Nr. 420/1 Prot., datë 10.02.2023 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit “Për dërgim të pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2022”, në të cilin përfshihet edhe regjistri i riskut për vitin 2023.

Nga auditimi u konstatua se, në identifikimin e risqeve për vitin 2022 është identifikuar një risk i përgjithshme mbi sistemet TI në Policinë e Shtetit ndërsa për vitin 2023 janë identifikuar risqe të përgjithshme mbi sistemin eGjoba të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por nuk ka risqe të identifikuar specifike në lidhje me sigurinë e informacionit.

1.b Menaxhimi i ndryshimeve në proceset e informatizuara

Procesi i kontrolleve të ndryshimit nevojitet për të siguruar se të gjithë konfigurimet e ndryshimeve të sistemeve janë të autorizuara, testuara, dokumentuara dhe kontrolluara në mënyrë që sistemet të vazhdojnë të mbështesin operacionet e institucionit sipas planit dhe në mënyrë që të gjitha gjurmët të dokumentohen. Një ndryshim i paaprovuar ose aksidental mund të ketë risqe të ndryshme dhe pasoja financiare për institucionin.

Për këtë pikë grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion Manuali “Për Sigurinë e Informacionit”, miratuar me nr. 1237 datë 31.08.2023, me objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave të Përgjithshme të Sigurisë së Informacionit në Policinë e shtetit dhe përcaktimin e përgjegjësive për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit të DPPSH:

- Asnjë zhvillim/ndryshim aplikimi nuk duhet të kryhet në mjedise produkti. Për këtë duhet të jetë e detyrueshme kryeja me rigorozitet e kontrolleve të zëvendësimit dhe të kalimit të aplikimeve nga ambienti i tyre i zhvillimit në atë të testimit dhe nga ai i testimit, në atë të produktit;

- DTI është përgjegjës për kryerjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të analizës së riskut;

- Për të gjitha rastet që lidhen me sigurinë ndiqet një procedurë formale për raportimin e incidenteve që kanë të bëjnë me cënimin e sigurisë së rrjetit të Policisë së Shtetit (formular incident response). Të gjitha ngjarjet e dyshuara duhet të raportohen menjëherë nga Drejtori i Drejtorisë ku ndodh incidenti tek Drejtori i Departamentit për Teknologjinë e Informacionit duke plotësuar formularin përkatës. Më pas struktura duhet të trajtojë këtë informacion duke marrë masat paraprake të nevojshme dhe duke njoftuar Titullarin e Institucionit.

Nga auditimi u konstatua se, për sistemin eGjoba nuk janë dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në këtë sistem për periudhën e audituar. Megjithatë procesi i punës ka vijuar DTI nuk rezulton të ketë dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar këto ndryshime nga ana e saj. Aprovimi i çdo ndryshimi në sistem duhet të marrë miratim nga strukturat përkatëse përgjegjëse për impaktet e mundshme që sjellë secili prej tyre. Nuk ka asnjë dokument gjurmueshmërie për ndryshimet e ndodhura ashtu si është e përshkruar edhe në procedurën e ndryshimit.

Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve ka si qëllim të zgjidhë çështjet nëpërmjet investigimit dhe me analiza të thella, të incidenteve të mëdha ose të përsëritura, për të gjetur shkakun e ndodhjes. Pasi problemi është identifikuar dhe është kryer analiza e gjetjes së shkakut, shndërrohet në gabim të njohur ose joeficient, dhe më tej të zhvillohet një zgjidhje për të trajtuar atë dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me sistemin eGjoba nuk zhvillohet dokumentimi dhe monitorimi për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Për periudhën nën auditim problemet dhe incidentet janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh nuk ka një dokumentim të raportimit dhe zgjidhjes së tyre.

1.c Përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si dhe të drejtat e tyre

Procedura standarde për përcaktimin e rregullave, që duhen zbatuar nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit, gjatë përdorimit të llogarive në Sistemet e Teknologjisë së Informacionit “Për dhënien e të drejtës dhe mënyrës së përdorimit të llogarive në Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Policinë e Shtetit” është miratuar me Urdhër nr. 143 datë 04.02.2022. Sipas kësaj procedure aksesimi në aplikacionet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, që përfshihen në faqen e DTI-së, u lejohet punonjësve të policisë sipas niveleve dhe mbasi i është dhënë e drejta e përdorimit të një llogarie, me username dhe password personal. Fjalëkalimet për aplikacionet gjenerohen dhe u vihen në dipozicion përdoruesve, nëpërmjet Sektorit të Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave. Kërkesa për qasjen e përdoruesve në aplikacione, pas miratimit të eprorit të drejtpërdrejtë, i dërgohet në rrugë shkresore Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave ose elektronikisht, nëpërmjet adresës së e-mailit të qendrës së shërbimeve helpdesk helpdesk@asp.gov.al. Helpdesk koordinon punën me Sektorin e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave në DMIDH dhe njofton përdoruesit në rastet e kërkesave për qasje, të dërguara në rrugë elektronike.

Për krijimin e llogarive në rrjetin e Policisë së Shtetit, plotësohet formulari i të kërkesës për qasje, i bashkëlidhet dhe urdhri i emërimit të punonjësit, për të konfirmuar autenticitetin e kërkesës. Krijimi i përdoruesve realizohet sipas standardit emër.mbiemër në aplikacionet e lidhura me domainin ASP.GOV.AL.

Sektorin e Menaxhimit të Informacionit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, pasi bën verifikimin e punonjësit, përcakton të drejtat duke krijuar një profil, sipas detyrës funksionale të tij dhe vazhdon me procedurat e mëtejshme, për krijimin e përdoruesve (user) në këtë sistem.

Për çdo përdorues sistemi, që ndryshon funksion apo largohet nga detyra, Drejtoria e Burimeve Njerëzore njofton menjëherë Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, si dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, për ndryshimin ose mbylljen e qasjes/të drejtës në sistem/sisteme.

Drejtorin e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në koordinim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në mënyre periodike, duhet të rishikojë të gjithë përdoruesit dhe nivelin e qasjes së tyre, në përputhje me pozicionon aktual të punës.

Në sistemin eGjoba janë në total 4830 përdorues Aktiv dhe Jo Aktiv nga të cilët:

- Vetëm 117 prej tyre janë jo aktiv nga ku konstatohet se ka përdorues të cilët edhe pse kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të ndryshme kanë ende statusin aktiv në sistem;
- 308 usera e kanë fushën START_DATA të pa plotësuar;
- Nga 117 usera jo aktiv në sistem vetëm 2 prej tyre e kanë fushën END_DATE të plotësuar;
- 74 përdorues janë me username emër.mbiemërnumër dhe jo sipas formatit standard emër.mbiemër;
- Fushat që përmbajnë userat e sistemit eGjoba nuk janë të detyrueshme për t'u plotësuar për çdo përdorues. Nga verifikimi rezulton se 169 usera nuk kanë të plotësuar të gjitha fushat si 'officer_id', 'forename', 'surname', 'function' etj, por kanë të plotësuar vetëm fushat

'username', 'active' (nga të cilët 6 prej tyre rezultojnë jo aktivë), 'start_date' (nga të cilët 13 janë fusha boshe), 'end_date' (vetëm një username ka datë mbyllje), si dhe është përcaktuar 'roli' për secilin username;

- Nga verifikimi i userave të sistemit me ata të larguar në periudhën e audituar rezulton se ka usera të cilët nuk ekzistojnë fare në sistem;
- Ka përdorues të cilët janë jo aktiv dhe nuk kanë një datë mbyllje;
- Nga verifikimi rezulton se ka përdorues të cilët janë me emër dhe mbiemër përsëritës dhe janë shënuar si username në formë atin emër.mbiemërnumër;
- Hapja, mbyllja dhe ndryshimet e përdoruesve mbeten të pamonitoruara duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimit të tyre;
- Përdorues me username 'bashkia.shkoder' nuk identifikohen se kujt useri i përkasin, pra nuk lidhet me një përdorues të përvetshëm në mënyrë që të mbikëqyret se cili person e përdor;
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjellë risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve;
- Nga verifikimi rezulton se fusha Fuction nuk është e njëjta për funksione të njëjta që kryhen në sistemin eGjoba.

Gjithashtu nga auditimi mbi politikën e sigurisë së përdoruesve në sistemin eGjoba u konstatua se: nuk është hartuar një rregullore ose dokument mbi parametrizimin e fjalëkalimeve që të përcaktojë përmbajtjen, gjatësinë, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim etj. Nuk janë dokumentuar politikën e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

Nga auditimi mbi burimet njerëzore të strukturës së DTI dhe AB, u konstatua se:

- Në strukturën e miratuar për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit nga një numër total prej 102 punonjësish aktualisht janë 32 pozicione vakante. Strukturat me më shumë vakanca janë Drejtoria e Sistemeve, Qendra Operative e Sigurisë dhe Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Audituesit e strukturës së Auditit të Brendshëm kanë zhvilluar auditime në drejtim të teknologjisë së informacionit por me objektiv të kufizuar për asrye të mungesës në strukturë të specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit. Specialistët e fushës për auditimet që ata kanë zhvilluar i kanë marrë përkohësisht nga struktura e teknologjisë së informacionit në DPPSH duke u siguruar që mos të jenë në konflikt me procesin që është objekt auditimi.

Mungesa e punonjësve në drejtorinë e AB, nuk është në përputhje me nenin 4/pika 6, nenin 9/pika 1, nenin 11 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se:

- Për sistemin eGjoba nuk është hartuar dhe dokumentuar Strategjia e Backup e dedikuar dhe Strategjia e Rikuperimit e dedikuar me elementët që duhet të përfshihen sipas manualit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

- Nuk dokumentohet procesi i hartimit të planit të testimeve, i realizimit të testimeve dhe i rezultateve të dalës nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike, si dhe ruajtja e kopjes rezervë në një tjetër ambient.

Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit, përbën një risk për humbje të të dhënave dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje të shërbimeve, përcaktuar në VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar, Manuali "Për vazhdueshmërinë e punës, në rastet e ndodhjes së një incidenti, ndërprerje të

shërbimeve apo fatkeqësive” miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1238 datë 31.08.2023, manuali i auditimit IT, praktikat më të mira.

Nga auditimi u konstatua se nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe për sistemin e kundravajtjeve rrugore eGjoba, me qëllim identifikimin, ndjekjen dhe adresimin e përgjegjësive në drejtim të sigurisë së informacionit. Mangësitë në lidhje me identifikimin dhe dokumentimin e risqeve nuk janë në përputhje me nenin 11, pika 2, nenin 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se:

- DTI nuk ka dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në sistemin eGjoba gjatë periudhës së audituar. Megjithëse procesi i punës ka vijuar DTI nuk rezulton të ketë dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar këto ndryshime nga ana e saj. Nuk ka asnjë dokument gjurmueshmërie për ndryshimet e ndodhura ashtu si është e përshkruar edhe në procedurën e ndryshimit.

- Në lidhje me sistemin eGjoba nuk zhvillohet dokumentimi dhe monitorimi për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Për periudhën nën auditim problemet dhe incidentet janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh nuk ka një dokumentim të raportimit dhe zgjidhjes së tyre.

Konstatimet e mësipërme janë bazuar në manualin “Për Sigurinë e Informacionit”, miratuar me nr. 1237 datë 31.08.2023 nga Drejtori i Përgjithshëm në DPPSH, manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe praktikat më të mira.

Nga auditimi u konstatua se, në sistemin eGjoba janë në total 4830 përdorues Aktiv dhe Jo Aktiv nga të cilët:

- Vetëm 117 prej tyre janë jo aktiv nga ku konstatohet se ka përdorues të cilët edhe pse kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të ndryshme kanë ende statusin aktiv në sistem;
- 308 usera e kanë fushën START_DATA të pa plotësuar;
- Nga 117 usera jo aktiv në sistem vetëm 2 prej tyre e kanë fushën END_DATE të plotësuar;
- 74 përdorues janë me username emër.mbiemërnumër dhe jo sipas formatit standard emër.mbiemër;
- Fushat që përmbajnë userat e sistemit eGjoba nuk janë të detyrueshme për t’u plotësuar për çdo përdorues. Nga verifikimi rezulton se 169 usera nuk kanë të plotësuar të gjitha fushat si ‘officer_id’, ‘forename’, ‘surname’, ‘function’ etj, por kanë të plotësuar vetëm fushat ‘username’, ‘active’ (nga të cilët 6 prej tyre rezultojnë jo aktivë), ‘start_date’ (nga të cilët 13 janë fusha boshe), ‘end_date’ (vetëm një username ka datë mbyllje), si dhe është përcaktuar ‘roli’ për secilin username;
- Nga verifikimi i userave të sistemit me ata të larguar në periudhën e audituar rezulton se ka usera të cilët nuk ekzistojnë fare në sistem;
- Ka përdorues të cilët janë jo aktiv dhe nuk kanë një datë mbyllje;
- Nga verifikimi rezulton se ka përdorues të cilët janë me emër dhe mbiemër përsëritës dhe janë shënuar si username në formatin emër.mbiemërnumër;
- Hapja, mbyllja dhe ndryshimet e përdoruesve mbeten të pamonitoruara duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre;
- Përdorues me username ‘bashkia.shkoder’ nuk identifikohen se kujt useri i perkasin, pra nuk lidhet me një përdorues të përvetshëm në mënyrë që të mbikëqyret se cili person e përdor;
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjell risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve;

- Nga verifikimi rezulton se fusha Fuction nuk është e njëjta për funksione të njëjta që kryhen në sistemin eGjoba.

Keq administrim i përdoruesve të sistemeve që DPPSH ka në përdorim, krijon kushte për shkelje të aksesimit të paautorizuar, në kundërshtim me nenin 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, ISO/IEC 27001 “Information security management”.

Nga auditimi u konstatua se, nuk është hartuar një rregullore ose dokument mbi parametrizimin e fjalëkalimeve që të përcaktojë përmbajtjen, gjatësin, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim etj. Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

Forcimi i kriterëve të fjalëkalimit konsiderohen element sigurie në standardet mbi sigurinë e informacionit.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 29.03.2024, protokolluar në DPPSH me nr. 685/1 prot., datë 29.03.2024 si dhe trajtuar në faqet 9-18 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

a. Investimet në teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 2/a “Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit; Investimet në teknologjinë e informacionit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2022 – 31.12.2023;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas bazës së riskut;
- 3- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve
- 4- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 5- Sistemi elektronik i APP për procedurat e DPPSH.

Bazuar në Regjistrin e Realizimeve të DPPSH për vitin 2022 dhe 2023, vënë në dispozicion të grupit të auditimit, procedurat në fushën e teknologjisë së informacionit që ka zhvilluar subjekti dhe që grupi i auditimit ka kërkuar t’u vihen në dispozicion, janë përzgjedhur me anë të kriterëve të riskut dhe vlerës së fondit limit.

Nga 11 procedura auditimi të përzgjedhura në fushën e IT, grupi i auditimit ka shqyrtuar dhe audituar 3 procedura që janë të lidhura me objektin e auditimit (sistemi e-gjoba), e specifikisht:

1. “Instalim kabineti Outdoor” (fond limit 1,800,000 lekë pa TVSH), viti 2023;
2. “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së” (fond limit 2,080,440 lekë pa TVSH), viti 2022;
3. “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për sistemin LAN (fond limit 7,000,000 lekë pa TVSH), viti 2023.

Pas shqyrtimit të dosjeve të vëna në dispozicion, është konstatuar se procedurat e tjera të prokurimit janë kryer e zhvilluar nga AKSHI në bazë të Marrëveshjeve Kuadër që ka lidhur ky i fundit me operatorët ekonomikë në treg.

1. Mbi procedurën e prokurimit me objekt “Instalim kabineti Outdoor”, viti 2023:

Tabela 1: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë REF-72714-06-15-2023

1. Urdhër Prokurimi: nr. 34, datë 15.06.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:
---	---	--

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur e thjeshtuar”	1. N. H. 2. S. F. 3. E. L.	1. K. K. 2.N. S. (zëvendësuar nga Olsi Lamçellari) 3. M. L.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,800,440 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,746,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 21,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 27.06.2023	9. Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët ekonomikë: a) pjesëmarrës në tender 1 OE b) skualifikuar 0 OE c) kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – Jo APP - Po KPP - Jo		
12. Lidhja e kontratës: nr. 34/13, datë 23.08.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSh): 2,095,200 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 60 ditë nga lidhja e kontratës

Kjo procedurë prokurimi ka qenë e parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve për vitin 2023 me fond të përllogaritur në vlerën 1,800,000 lekë dhe lloji i procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

a. Specifikimet teknike, përllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Më datë 23.01.2023, Drejtoria e Mbështetjes Logjistike ka hartuar Urdhrin nr. 04, (nr. 292 prot.) “Për krijimin e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike, përllogaritjen e sasisë dhe fondit limit për mallrat, shërbimet dhe investimet që janë planifikuar të prokurohen të përqendruara me buxhetin e vitit 2023”. Për procedurën me objekt “Instalim kabineti Outdoor”, Komisioni për Specifikimet Teknike përbëhej si vijon: a) F. X., DTI; b) M. L., DTI; c) S. F., DTI.

Komisioni për përllogaritjen e fondit limit përbëhej nga: a) S. H., DTI; b) A. S., DTI; c) E. S. (DTI).

Më datë 03.05.2023, Drejtori i Drejtorisë Teknike i ka kërkuar Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike kërkesë për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “Instalim kabineti Outdoor” në pikat e transmetimit të sistemit Datacom për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, bazuar në argumentimin e nevojave për këtë shërbim. Ky argumentim ka marrë në konsideratë: gjendjen teknike të kabineteve ekzistuese, rëndësinë e pikës repertitore, historikun e problematikave dhe periudhën e gjatë të vënies në punë të tyre.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 34, datë 15.06.2023, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar DST për procedurën e prokurimit “Instalim kabineti Outdoor” me fond limit 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, me përbërje si më poshtë:

1. N. H.; 2. S. F.; 3. E.L.

Komisioni për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike ka mbajtur procesverbalin nr. 36/3 të datës 15.06.2023, në të cilin ka argumentuar dhe kriteret e veçanta të vendosura mbi:

Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore për të paktën një nga tre vitet e fundit financiare duhet të jetë jo më e vogël se 30% e fondit limit sipas argumentimit: “Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesa e mësipërme i shërben AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”

Kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme të sukseshme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 19% të vlerës së fondit limit. Argumentimi sipas nenit 77, pika 4 e LPP dhe nenit 55, pika 4/b e VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”: *“Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar”.*

2. Autorizim nga prodhuesi ELTEK ose distributori i autorizuar i lëshuar për OE fitues, i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për objektin e prokurimit. Në rastin e dokumentave të lëshuara nga Distributori i autorizuar, OE duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës. Argumentimi i këtij kriteri nga AK është si vijon: *“...Kabineti që do të instalohet është pjesë e një rrjeti më të madh ekzistues nga përfituesi. Si ky kabinet, edhe pjesa tjetër ekzistuese, janë të prodhuesit ELTEK. Për të garantuar që instalimi i këtij kabineti dhe përfshirja në rrjetin ekzistues, në përputhje të plotë me specifikimet teknike jo vetëm të kësaj pajisjeje, por të të gjithë rrjetit, nevojitet që OE të ketë autorizim nga Prodhuesi ELTEK për të vërtetuar aftësinë e tij në instalimin, operimin dhe konfigurimin e kabinetit në tërësi.”*

3. a) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 45001:2018 (Për sigurinë dhe shëndetin në punë).

4. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 1 inxhinier elektronik/telekomunikacioni dhe min. 1 specialist të certifikuar për instalimin e kabinetit dhe radizatorit.

- Më datë 19.06.2023, APP i rekomandon AK, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke iu përmbajtur rigorozisht përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, të saktësojë/riformulojë kriteret, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues apo që mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO. Konkretisht, APP i ka sugjeruar AK *“rivlerësimin e kërkesës që OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “Autorizim nga Prodhuesi ELTEK”, si dhe të pranojë edhe ekuivalentet e këtyre autorizimeve, duke mbajtur në konsideratë nenin 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën”.*

Në zbatim të rekomandimeve të APP, AK ka ndryshuar kriterin 2.3.2 të kritereve të veçanta me anë të një shtojce në DST, nga *“Autorizim nga Prodhuesi ELTEK ose Distributori i autorizuar”* në *“Autorizim nga Prodhuesi ELTEK/ekuivalent ose Distributori i autorizuar”*. Të gjitha pikat e tjera të DST kanë mbetur të pandryshuara.

b. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 34/1, datë 15.06.2023, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: 1. K. K. (Përgjegjës i Sektorit të Prokurimit); 2. N.S. (Specialiste, DTI), ndryshuar me Urdhrin nr. 34/6, datë 27.07.2023 dhe zëvendësuar me O. L. (Specialist, DTI); 3. M.L. (Specialiste, Sektori i Prokurimit).

Hapja e ofertave është kryer më datë 27.06.2023, ora 10.00.

Pjesëmarrës në këtë procedurë ka qenë Operatori Ekonomik:

- OE “T.” shpk me ofertë 1,746,000 (një milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë pa tvsh ose 2,095,200 (dy milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind) me TVSH.

Operatori “T.” shpk kualifikohet pasi plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe oferta e tij është shpallur fituese e procedurës. Ankesa brenda afatit 7-ditor nuk ka patur.

- Në datën 17.08.2023 është mbajtur dhe raporti përmbledhës i procedurës nga ana e KVO. Më datë 23.03.2023 është lidhur kontrata midis AK, DPPSH dhe Kontraktuesit “T.” me objekt *“Instalim kabineti Outdoor”* me afat realizimi 60 ditë dhe vlerë totale 1,746,000 (një milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë pa tvsh ose 2,095,200 (dy milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind) me TVSH.

c. Zbatimi i kontratës

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 34/15, datë 24.08.2023 është urdhëruar ngritja e grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Instalim kabineti Outdoor” me përbërje: 1. K. K. (Kryetar) 2. N. H. (Anëtar). Më datë 07.09.2023, me Urdhrin nr. 36, është ngritur Ekipi i Menaxhimit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr. 34/13, datë 23.08.2023, me përbërje: N.P. (Kryetar, Specialist IT); T. M. (Anëtar, Specialist IT); 3. A. S. (Anëtar, Specialist IT). Më datë 08.09.2023 është bërë dhe Plani i zbatimit të kontratës, i cili është dërguar pranë APP më datë 22.09.2023.

Grupi i auditimit konstaton se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Mbi procedurën e prokurimit “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së”, viti 2022:

Tabela 2: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë REF-34277-06-24-2022

1. Urdhër Prokurimi: nr. 35, datë 23.06.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit 1. N. H. 2. E. N. 3. E. L.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1. K. K. 2. S. D. 2. M. L.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur e thjeshtuar” nëpërmjet marrëveshjes kuadër me një OE		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,080,440 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,669,650 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 410,790 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 05.07.2022	9. Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët ekonomikë: a) pjesëmarrës në tender 2 OE b) skualifikuar 0 OE c) kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – Jo APP - Jo KPP - Jo		
12. Lidhja e kontratës: nr. 58/5, datë 20.10.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSh): 2,003,580 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 12 muaj nga lidhja e kontratës

Kjo procedurë prokurimi ka qenë e parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve për vitin 2022 me fond të përllogaritur në vlerën 2,080,440 lekë dhe lloji i procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

a. Specifikimet teknike, përllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Më datë 27.01.2022, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse ka hartuar Urdhin nr. 03, (nr. 331 prot.) “Për krijimin e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike, përllogaritjen e sasisë dhe fondit limit për mallrat, shërbimet dhe investimet që janë planifikuar të prokurohen të përqendruara me buxhetin e vitit 2022”. Për procedurën me objekt “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së”, Komisioni për Specifikimet Teknike përbëhet si vijon: a) O. L, DTI; b) E. N., DTI; c) N. P., DTI.

Komisioni për përllogaritjen e fondit limit përbëhet nga: a) G. A., DTI; b) S. H., DTI; c) A. B., DTI.

Më datë 06.05.2022, Drejtori i Teknologjisë së Informacionit i ka kërkuar Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike kërkesë për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së” në komisaritet e Policisë së Shtetit, bazuar në argumentimin e nevojave për këtë shërbim.

Më datë 11.05.2022, me shkresën nr. 67/2 prot., DTI i ka dërguar Sektorit të Prokurimit kërkesë për lidhjen e marrëveshjes kuadër për një periudhë kohe 12 mujore me objekt “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së”.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 35, datë 23.06.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar DST për procedurën e prokurimit “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së” me fond limit 2,080,440 (dy milion e tetdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lekë pa TVSH, me përbërje si më poshtë:

1. N. H.; 2. E. N.; 3. E. L.

Komisioni për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike ka vënë në dispozicion të Njesisë së Prokurimit specifikimet teknike, argumentimin e sasësisë dhe fondit limit për objektin e prokurimit me shkresën nr. 1521 prot., datë 11.05.2022, në të cilin ka argumentuar dhe kriteret e veçanta të vendosura mbi:

Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore për të paktën një nga tre vitet e fundit financiare duhet të jetë jo më e vogël se 30% e fondit limit të vënë në dispozicion sipas argumentimit: *“Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesa e mësipërme i shërben AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”*

Kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme të sukseshme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 19% të vlerës së fondit limit. Argumentimi sipas nenit 77, pika 4 e LPP dhe nenit 55, pika 4/b e VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: *“Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar”.*

2. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 1 inxhinier mekanik/ dhe 1 inxhinier elektrik sipas objektit të prokurimit (mirëmbajtje kondicionerësh).

3. Operatori duhet të disponojë në pronësi ose me qera të paktën 2 mjete transporti me kalueshmëri të lartë (pick up).

b. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 35/2, datë 23.06.2022, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: 1. K. K. (Përgjegjës i Sektorit të Prokurimit); 2. S. D. 3. M. L. (Specialiste, Sektori i Prokurimit).

Hapja e ofertave është kryer më datë 05.07.2022, ora 10.00.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë Operatorët Ekonomikë:

- OE “A.” shpk me ofertë 1,669,650 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh ose 2,003,580 (dy milion e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë) me TVSH.

Operatori “A.” shpk kualifikohet pasi plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe oferta e tij është shpallur fituese e procedurës. Ankesa brenda afatit 7-ditor nuk ka patur.

- OE “S.” shpk me ofertë 1,749,000 (një milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë) lekë pa tvsh ose 2,098,800 (dy milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) me TVSH.

Operatori “S.” shpk kualifikohet pasi plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe oferta e tij është shpallur fituese e procedurës. Ankesa brenda afatit 7-ditor nuk ka patur.

Si ofertë e sukseshme është shpallur oferta e OE “A.” me vlerë 1,749,000 lekë pa TVSH.

- Në datën 06.08.2022 është mbajtur dhe raporti përmbledhës i procedurës nga ana e KVO.

- Midis AK DPPSH dhe Kontraktuesit “A.” janë lidhur dy kontrata me objekt “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së” sipas marrëveshjes kuadër, me afat realizimi 12 muaj:

- 1) Kontrata nr. 58/5 datë 20.10.2022 me vlerë totale 1,021,200 (një milion e njëzet e një mijë e dyqind) lekë me tvsh;
- 2) Kontrata nr. 58/13 datë 23.03.2023 me vlerë totale 703,200 (shtatëqind e tre mijë e dyqind) lekë me tvsh.

c. Zbatimi i kontratës

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 58, datë 22.09.2022 është urdhëruar ngritja e komisionit të ndjekjes së marrëveshjes kuadër me përbërje:

1. K. K. (Kryetar) 2. E. L. (anëtare) 3. M. L. (anëtare).

Më datë 24.03.2023, me Urdhrin nr. 36, është ngritur Komisioni për ndjekjen, hartimin e planit të kontratës nr. 58/13, datë 23.03.2023, me përbërje: 1. K. K. (Kryetar) 2. N. H. (Anëtar).

Grupi i auditimit konstaton se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Më datë 19.01.2024, me shkresën nr. 129 prot., DTI i ka dërguar Qendrës së Furnizimit Materialo Teknike (QFMP) dokumentacionin për realizimin e Kontratës së Shërbimit me nr. 58/13, datë 23.03.2023, si dhe raportin e pranimit të shërbimit, pas vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga OE A. Shpk dhe raporteve të mirëmbajtjes.

3. Mbi procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023:

Tabela 3: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë REF-72746-06-16-2023

1. Urdhër Prokurimi: nr. 35, datë 15.06.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit 1. N. H. 2. F. X. 3. E. L.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1. K. K. 2. M. L. 3. S. F.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 7,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 6,685,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 315,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 30.06.2023, ora 10.00	9. Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët ekonomikë: a) pjesëmarrës në tender 1 OE b) skualifikuar 0 OE c) kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – Jo APP - Po KPP - Jo		
12. Lidhja e kontratës: nr. 34/13, datë 23.08.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSh): 8,022,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 60 ditë nga lidhja e kontratës

Kjo procedurë prokurimi ka qenë e parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve për vitin 2023 me fond të përlogaritur në vlerën 7,000,000 lekë dhe lloji i procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

a. Specifikimet teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Më datë 24.05.2023, me shkresën nr. 930 prot., Drejtori i Drejtorisë Teknike i ka kërkuar Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike kërkesë për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt

“Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, bazuar në argumentimin e nevojave për këtë shërbim.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 35, datë 15.06.2023, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar DST për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN” me fond limit 7,000,000 (shtatë milion) lekë pa TVSH.

Komisioni për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike ka mbajtur procesverbalin nr. 36/3 të datës 15.06.2023, në të cilin ka argumentuar dhe kriteret e veçanta të vendosura mbi:

Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore për të paktën një nga tre vitet e fundit financiare duhet të jetë jo më e vogël se 30% e fondit limit sipas argumentimit: *“Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesa e mësipërme i shërben AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”*

Kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme të sukseshme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 19% të vlerës së fondit limit. Argumentimi sipas nenit 77, pika 4 e LPP dhe nenit 55, pika 4/b e VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: *“Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar”.*

2. OE duhet të disponojë minimumi:

- a) të paktën 1 specialist të certifikuar për menaxhim projektesh, PRINCE 2 ose ekuivalent
- b) të paktën 1 specialist të certifikuar ITIL ose ekuivalent për menaxhimin e shërbimeve IT
- c) të paktën 2 specialistë të certifikuar CCNP për sigurinë ose ekuivalent
- d) të paktën 1 specialist të certifikuar CCNP për rrjetin ose ekuivalent

Me shtojcën nr. 35/6 të datës 29.06.2023, DST ndryshohen në pikën c), e cila bëhet “të paktën 1 specialist të certifikuar CCNP për sigurinë ose ekuivalent”. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e rekomandimit të APP më datë 22.06.2023 për të mos kufizuar konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe me arsyetimin se është i mjaftueshëm edhe një specialist CCNP.

3. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit:

- ISO 9001:2015 (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë)
- ISO 27001:2013 (Për sigurinë e informacionit)
- ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve në TI)

4. Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i lëshuar për OE fitues, i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për objektin e prokurimit. Në rastin e dokumentave të lëshuara nga Distributori i autorizuar, OE duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës.

Grupi i auditimit ka konstatuar se:

Kriteri nr. 2 i mësipërm, pika a), *“të paktën 1 specialist të certifikuar për menaxhim projektesh, PRINCE 2 ose ekuivalent”* është i panevojshëm dhe cenon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë. Certifikata për menaxhim projektesh (PRINCE 2 ose ekuivalent) shërben për menaxhimin efektiv të një projekti, duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit. Mirëmbajtja dhe vendosja e pjesëve për pajisjet e rrjetit LAN nuk është një projekt, por një procedurë e zakonshme prokurimi malli/shërbimi. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos

shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Për këtë arsye, vendosja e kriterit të mësipërm është në kundërshtim me nenet 2, 3, 21 dhe 36 të LPP.

Gjithashtu, konstatohet se kriteret nr. 2 dhe 3 mbi kapacitetin teknik nuk janë të argumentuara teknikisht, por vetëm ligjërish, në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*”.

Për sa më sipër:

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. N. H., Specialist prokurimi, personi përgjegjës, z. F. X., Specialist DTI, specialist fushe dhe znj. E. L., Specialiste Sektori i Prokurimit, në përputhje me nenin 74, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “*Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit:*

- *Hartimi i specifikimeve teknike;*
- *Përlllogaritja e fondit limit;*
- *Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;*
- *Hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;*
- *Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimin).*

Në rast se detyrat e sipërpërmendura në këtë pikë nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet.”

b. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 35/1, datë 15.06.2023, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: 1. K. K. (Përgjegjës i Sektorit të Prokurimit); 2. S. F. (Specialiste, DTI); 3. M. L. (Specialiste, Sektori i Prokurimit).

Hapja e ofertave është kryer më datë 30.06.2023, ora 10.00.

Pjesëmarrës në këtë procedurë ka qenë Operatori Ekonomik:

- OE “S.” shpk me ofertë 6,685,000 (gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh ose 8,022,000 (tetë milion e njëzet e dy mijë) me TVSH.

Operatori “S.” shpk kualifikohet pasi plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe oferta e tij është shpallur fituese e procedurës. Ankesa brenda afatit 7-ditor nuk ka patur.

Me procesverbalin nr. 35/9 prot., datë 14.07.2023, KVO ka klasifikuar si ofertë të suksesshme ofertën e OE “S.” shpk.

Në datën 28.07.2023 është mbajtur dhe raporti përmbledhës i procedurës nga ana e KVO.

Më datë 07.08.2023 është lidhur kontrata midis AK DPPSH dhe Kontraktuesit “S.” me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN” me afat realizimi 60 ditë dhe vlerë totale 8,022,000 (tetë milion e njëzet e dy mijë) me TVSH.

c. Zbatimi i kontratës

Me urdhrin e Drejtuesit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 35/15, datë 8.08.2023 është urdhëruar ngritja e Komisionit të ndjekjes dhe hartimit të planit të zbatimit të kontratës me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN” me përbërje: 1. K.K. (Kryetar) 2. N. H. (Anëtar).

Më datë 07.09.2023, me Urdhrin nr. 37, është ngritur Ekipi i Menaxhimit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr. 35/13, datë 07.08.2023, me përbërje: D. G. (Kryetar, Specialist IT); V. J. (Anëtar, Specialist IT); 3. S. F. (Anëtar, Specialist IT).

Më datë 08.09.2023 është bërë dhe Plani i zbatimit të kontratës, i cili është dërguar pranë APP më datë 26.09.2023.

Grupi i auditimit konstaton se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, kriteri i veçantë nr. 2, pika a), “të paktën 1 specialist të certifikuar për menaxhim projektsh, PRINCE 2 ose ekuivalent” është i panevojshëm, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, si dhe cenon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë. Certifikata për menaxhim projektsh (PRINCE 2 ose ekuivalent) shërben për menaxhimin efektiv të një projekti, duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit. Mirëmbajtja dhe vendosja e pjesëve për pajisjet e rrjetit LAN nuk është një projekt, por një procedurë e zakonshme prokurimi malli/shërbimi. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Për këtë arsye, vendosja e kriterit të mësipërm është në kundërshtim me nenet 2, 3, 21 dhe 36 të LPP.

Hartimi i kërkesave dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të panevojshme dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi është në kundërshtim me nenet 2, 3, 21 dhe 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se kriteret e veçanta nr. 2 dhe 3 mbi kapacitetin teknik nuk janë të argumentuara teknikisht, por vetëm ligjërish, në kundërshtim kjo me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”. Hartimi i kërkesave dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të paargumentuara është në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit me objekt, përkatësisht, “Instalim kabineti Outdoor”, viti 2023; “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverash dhe sallat e IT-së”, viti 2022; “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vonesa në zbatimin e kontratës është në kundërshtim me nenin 124, pika 3 dhe nenin 125, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenin 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.2, datë 29.03.2024, protokolluar në DPPSH me nr. 685/2 prot., datë 29.03.2024 si dhe trajtuar në faqet 18-34 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit

Në zbatim të pikës 2.b “Marrëveshjet e nivelit të shërbimit”, u shqyrtuan zbatimet mbi marrëveshjet në nivel shërbimi kontraktuar nga AKSHI, si më poshtë:

Objektivi	Kontrata, Data	Vlera e kontratës	Implementim	Mirëmbajtje	Afati
Ngritja e sistemit të gjobave elektronike për Policinë e Shtetit	Nr. 3921, 07.08.2018	227,549,983	142,674,063	84,875,920	48 muaj
Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit	Nr. 20, 16.08.2022	327,963,170	257,963,170	70,000,000	24 muaj
Totali për 6 vjet.		555,513,153	400,637,233	154,875,920	

I. Kontrata nr.3921, datë 07.08.2018 me objekt “Ngritja e sistemit të gjobave elektronike për Policinë e Shtetit”, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n, i cili ka qenë dhe institucioni që ka kryer detyrimet financiare. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka qenë përfitues i këtij shërbimi të informatizuar.

Vlera e kontratës për ndërtimin e këtij sistemi dhe mirëmbajtjen e tij është 227,549,983 lekë pa TVSH, me vlerë implementimi 142,674,063 lekë, ndërsa vlera e mirëmbajtjes është 84,875,920 lekë. Afati i implementimit të këtij sistemi është 4 muaj, ndërsa mirëmbajtja për 48 muaj.

Kërkesat për realizimin e kësaj kontrate, specifikuar dhe në termat e referencës kanë qenë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sasia
1	Pajisje mobile	250
2	Printera mobile	250
3	Bateri rezerve për pajisjet mobile	50
4	Bateri rezerve për printerat mobile	50
5	Sistem për menaxhimin e pajisjeve mobile	1
6	Rrula letre	5000
7	Zhvillim sistemi dhe aplikacioni mobile për gjobën elektronike	1
8	Zhvillim i webserviceve, për komunikim të sistemit eGjoba me aplikacionin dhe e-albania;	1
9	Instalim dhe përgatitje e pajisjeve	250
10	Trajnim për agjentët e policisë	250

Grupi i auditimit arriti të sigurojë dokumentacionin e përmendur më sipër, për shërbimin e mirëmbajtjes me disa ditë vonesë nga kërkesa që bëri tek departamenti i IT.

Raportet periodike të mirëmbajtjes për periudhën objekt auditimi janar 2022 – korrik 2022, i përkasin ndjekjes dhe zbatimit të kontratës nr.3921, datë 07.08.2018.

Ndjekësit e kontratës për këtë periudhë kanë qenë:

- Znj.B. Z. – Përfaqësues për DPPSH;
- Z. E. C. – Përfaqësues për AKSHI;
- Znj. D. Xh. – Përfaqësues për AKSHI.

Nga auditimi mbi dokumentet e vëna në dispozicion për ndjekjen e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, për periudhën 2018-2022 u konstatua se DPPSH nuk është përfaqësuar me asnjë punonjës të Drejtorisë së Policisë Rrugore në cilësinë e përfituesit të shërbimit, por është përfaqësuar në ndjekjen e kontratës me një punonjës nga struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Asnjë nga specialistët e caktuar si ndjekës kontrate prej dy

institucioneve AKSHI dhe DPPSH nuk është njohës i proceseve operacionale në Drejtorinë e Policisë Rrugore, që realizohen nëpërmjet sistemit eGjoba.

Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, për zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018 me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, ka vijuar përgjatë kësaj periudhe me problematika të cilat janë detajuar sipas periudhave më poshtë:

- Për shërbimin e kryer për muajin janar 2022 jemi vënë në dijeni se në sistemin e menaxhimit të kontratave është ngarkuar vetëm fatura e shërbimit, me datë fature 09.02.2022, ndërsa në sistemin e SMK është nënshkruar nga OE në datën 10.02.2022 dhe nga ndjekësja e kontratës znj.B. Z. në datën 09.03.2022;

- Për shërbimin e kryer për muajin shkurt 2022, nuk na është vënë asnjë dokument në dispozicion që të tregojë se shërbimi është kryer;

- Për shërbimin e kryer për muajin mars 2022, me datë fature 07.04.2022, ndërsa në sistemin e SMK dokumentacioni është nënshkruar nga OE në datën 07.04.2022.

Ndjekësit e kontratës znj.B. Z. në datën 19.05.2022, z.E. C. në datën 19.05.2022 dhe znj.D. Xh. në datën 16.06.2022 kanë nënshkruar raportin e mirëmbajtjes si dhe faturimin e kësaj periudhe;

- Për shërbimin e kryer për muajin prill 2022, janë ngarkuar dhe nënshkruar 3 dokumente në sistemin e menaxhimit të kontratave që janë: faturimi, raporti mujor i mirëmbajtjes si dhe shkresa me nr. 3921/7 prot, datë 09.05.2022.

Ndjekësja e kontratës znj.B. Z. ka nënshkruar marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes në maj në datën 19.05.2022. Z.E. C. ka nënshkruar marrjen në dorëzim në datën 19.05.2022, ndërsa znj.D. Xh. ka nënshkruar në datën 16.06.2022. Pra, në të njëjtën datë në muajin maj, ndjekësit e kontratës kanë pranuar shërbimin e mirëmbajtjes për periudhat mars-prill, pra jashtë çdo afati të arsyeshëm;

- Për shërbimin e kryer për muajin maj 2022, janë ngarkuar dhe nënshkruar 3 dokumente në sistemin e menaxhimit të kontratave që janë: faturimi, raporti mujor i mirëmbajtjes si dhe shkresa me nr. 3921/8 prot, datë 08.06.2022.

Ndjekësit e kontratës znj.B. Z. dhe znj.D. Xh. kanë nënshkruar duke bërë dhe marrjen në dorëzim në datën 16.06.2022, ndërsa z.E. C. ka nënshkruar në datën 28.06.2022;

- Për shërbimin e kryer për muajin qershor 2022, nuk na është vënë asnjë dokument në dispozicion që të tregojë se shërbimi është kryer;

- Për shërbimin e kryer për muajin korrik 2022, janë ngarkuar dhe nënshkruar 3 dokumente në sistemin e menaxhimit të kontratave që janë: faturimi, shkresa me nr.3921/10 prot, datë 10.08.2022 si shkresë shoqëruese e raportit periodik mujor, procesverbal i datës 16.09.2022 që tregon se është marrë në dorëzim shërbimi periodik mujor për periudhën 08.07.2022-07.08.2022. Për këtë periudhë nuk na është vënë në dispozicion një raport mbi çfarë shërbimi është kryer si mirëmbajtje nga OE.

Procesverbali i mbajtur nga ndjekësit është nënshkruar nga ndjekësit në këto data: znj.B. Z. në datën 31.10.2022, znj.D. Xh. në datën 30.09.2022 dhe z.E. C. në datën 30.09.2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, për zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018 me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, u konstatua se dokumentet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në disa raste mungojnë e në disa raste janë nënshkruar në grup për 2 apo 3 muaj shërbim mirëmbajtje njëkohësisht, çfarë tregon për një vijimësi formale në ndjekjen e zbatimit të kontratës. Nuk janë raportuar problematika në lidhje me sistemin eGjoba duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë problematikë, megjithëse vetë agjentët e policisë u shprehën se deri në fund të vitit 2023 sistemi ka shfaqur probleme të vazhdueshme.

Raportet e kërkuara mbi filtrimin e të dhënave të populluara elektronikisht të parashikuara në termat e referencës për këtë kontratë janë për gjodat e vendosura:

- Sipas datës;
- Llojit të shkeljes;

- Agjentit të policisë që ka konstatuar shkeljen;
- Vendndodhjes, etj.

Nga auditimi mbi raportet e kërkuara sipas specifikimeve teknike, për filtrimin e të dhënave të populluara elektronikisht, u konstatua se aktualisht nuk janë ndërtuar raporte sipas llojit të shkeljes dhe sipas zonave. Kjo kërkesë e specifikimeve teknike rezulton e paplotësuar aktualisht nga OE.

II. Kontrata nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, është nënshkruar nga AKSHI si Autoritet Kontraktor dhe institucioni që kryen detyrimet financiare. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është përfitues i përmirësimit të këtij shërbimi të informatizuar.

Vlera e kontratës për përmirësimin e këtij sistemi është 327,963,170 lekë pa TVSH, me vlerë implementimi 257,963,170 lekë, ndërsa vlera e mirëmbajtjes është 70,000,000 lekë. Afati i implementimit të këtij përmirësimi është 12 muaj, ndërsa mirëmbajtja për 24 muaj.

Kërkesat për realizimin e kësaj kontrate, specifikuar dhe në termat e referencës kanë qenë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia
	Përmirësimi i sistemit eGjoba	1
1	Pajisje tablet	250
2	Printera mobile	250
3	Pajisje tablet për supervisorët	25
4	Licenca për sistemin e menaxhimit të pajisjeve mobile	525
5	Zgjidhje VPN enterprise	1
6	Instalime, konfigurime dhe integrimet e pajisjeve fizike dhe sistemeve	1
8	Trajnim për agjentët e policisë dhe supervisorëve	3
9	Mirëmbajtje	4 vite

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi gusht 2022 – dhjetor 2023, raportet periodike të mirëmbajtjes janë në zbatim të kontratës nr. 20, datë 16.08.2022.

Me shkresën nr. 6159/2, datë 12.10.2022 të titullarit të DPPSH, si ndjekës i kontratës nr. 20 është caktuar punonjësi z. B. V..

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, u konstatua se në vitin 2022 me përfundimin e afatit të kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, shërbimi i mirëmbajtjes nuk ka përfunduar, por ka vazhduar me kriteret dhe vlerën e kësaj mirëmbajtje, megjithëse është nënshkruar kontrata e re nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”. Mirëmbajtja ka vijuar sipas kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, në vlerën e cila ka qenë parashikuar prej 1,768,248 lekë në muaj, megjithëse afati i saj ka përfunduar në datën 07.08.2022.

Grupi i auditimit kishte akses të kufizuar në dokumentacionin e plotë të mbajtur për këtë kontratë, pasi dokumentacioni nuk gjendej në DPPSH, por tek AKSHI si Autoriteti Kontraktor.

Nga auditimi mbi dokumentet e vëna në dispozicion për ndjekjen e kontratës nr.20, datë 16.08.2022, për periudhën 2022-2023 u konstatua se DPPSH nuk është përfaqësuar me asnjë punonjës të Drejtorisë së Policisë Rrugore në cilësinë e përfituesit të shërbimit, por është përfaqësuar në ndjekjen e kontratës me një punonjës nga struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Asnjë nga specialistët e caktuar si ndjekës kontrate prej dy institucioneve AKSHI dhe DPPSH nuk është njohës i proceseve operacionale në Drejtorinë e Policisë Rrugore, që realizohen nëpërmjet sistemit eGjoba.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion, për realizimin e kontratës nr.20, datë 16.08.2022 janë kërkuar pajisje dhe përmirësim në disa elementë të sistemit ekzistues si dhe funksionalitete të reja.

Për pajisjet është kërkuar:

- Shtimi me 250 tableta dhe 250 printera mobile që i shtohet 250 seteve ekzistues, për vendosjen e gjobave elektronike;
- Shtimi me 25 tableta dhe krijimin e modulit të supervizorëve.

Për sistemin është kërkuar:

- Licencimi i sistemit ekzistues MDM për 525 pajisjet e reja tablet dhe printerat mobile;
- Zhvillimi i Apit për të mundësuar integrim me Policinë Bashkiake;
- Përditësimi i eGjoba konform ndryshimeve të kodit rrugor datë 7.5.2021;
- Instalimin e një zgjidhjeje të posaçme VPN, për komunikimin e pajisjeve në terren me sistemin qendror;
- Integrimi në eGjoba i 110 tabletave të dhuruar nga projekti në ndihmë të policisë SIDA;
- Integrimi në eGjoba i 6 radarëve fiks ekzistues;
- Ndërveprimi me eGjoba i sistemit të radarit të montuar në mjetin inteligjent.

Në lidhje me raportet e reja është kërkuar të integrohen tek raportet ekzistuese dhe njëkohësisht të gjenerojnë raporte për gjobat të grupuara dhe /ose filtruara sipas:

- Datës;
- Llojit të shkeljes;
- Agjentit të policisë që ka konstatuar shkeljen;
- Vendndodhjes, etj.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se nuk janë plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara mbi raportimin, që janë:

- Raporti fillestar i prodhuar brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit;
- Draft Raporti Përfundimtar prej maksimumi 20 faqesh i prodhuar deri në 1 muaj para përfundimit të kontratës;
- Raporti final me të njëjtat specifika si Draft Raporti përfundimtar i prodhuar brenda 5 ditësh pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

Kontrata nr.20, datë 16.08.2022 “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, nuk është përmbushur në drejtim të integritit të pajisjeve radar në sistemin eGjoba.

*Nga auditimi mbi funksionet shitesë të parashikuara në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se disa nga kërkesat e specifikimeve teknike **nuk janë realizuar**, të cilat janë:*

- Integrimi me 6 pajisjet radar fiks dhe shfaqja e eventeve të këtyre pajisjeve, nuk është realizuar në sistemin eGjoba. Të dhënat e shpejtësisë, targës dhe fotografimi i tij nuk janë ekspozuar në sistemin eGjoba në mënyrë automatike sikurse është kërkuar në rubrikën “Integrimi në eGjoba i 6 radarëve fiks ekzistues”. Moduli i ndërtuar për regjistrimin e gjobave nga Salla e Monitorimit, nuk konsiderohet integrimi i pajisjeve, por është një ndërfaqe e zhvilluar për regjistrimin e kundërvajtjeve nga kjo strukturë operacionale;
- Integrimi me Policinë Bashkiake nuk është bërë nëpërmjet një API sikurse është kërkuar në specifikimet teknike, por me akses të drejtpërdrejtë në sistem;
- Nuk është ndërtuar ndërveprim me eGjoba i sistemit të radarit të montuar në mjetin inteligjent, sikurse është kërkuar në specifikimet teknike;
- Në rastin e targave të huaja nuk është bërë akoma i mundur ekspozimi i informacionit të kundërvajtjeve për sistemin TIMS që gjoba të paguhet në kufi kur mjeti del. Kjo kërkesë është parashikuar në specifikimet teknike në rubrikën “Integrimi i pajisjeve të matjes së shpejtësisë dhe verifikimit”.
- Nuk është ndërtuar ndërveprim për marrjen, ruajtjen dhe shfaqjen e informacioneve shitesë për automjetin nga DPSHTRR si ngjyra, fuqia motorike, viti i prodhimit të automjetit.

- Në rubrikën “Raporte” për të dy kontratat janë parashikuar raporte mbi të njëjtat kritere, pavarësisht që kontratat e nënshkruara për sistemin eGjoba janë zhvilluar me 4 vite diferencë. Nuk rezultojnë të jenë ndërtuar raporte bazuar në llojin e shkeljes apo sipas vendndodhjes që konsiderohen “Zona” sipas Policisë Rrugore, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar në rubrikën “Raporte”. Kjo kërkesë nuk është përmbushur që në kontratën e parë nr. 3921, datë 07.08.2018 dhe ka vijuar të mos jetë plotësuar me kontratën nr. 20, datë 16.08.2022.

Drejtoria e Policisë Rrugore nuk është përfaqësuar në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të lidhura për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit eGjoba.

Nga auditimi mbi dokumentet e vëna në dispozicion për ndjekjen e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, për periudhën 2018-2022, si dhe kontratën nr.20, datë 16.08.2022, për periudhën 2022-2023, u konstatua se DPPSH nuk është përfaqësuar me asnjë punonjës të Drejtorisë së Policisë Rrugore në cilësinë e përfituesit të shërbimit, por është përfaqësuar në ndjekjen e kontratës me një punonjës nga struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Asnjë nga specialistët e caktuar si ndjekës kontrate prej dy institucioneve AKSHI dhe DPPSH nuk është njohës i proceseve operacionale në Drejtorinë e Policisë Rrugore, që realizohen nëpërmjet sistemit eGjoba.

Mungesa e bashkëpunimit dhe bashkërendimi midis Drejtorisë së Policisë Rrugore dhe DTI për ndjekjen e kontratës cenon funksionalitetin në përdorimin e sistemit “egjoba”.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, për zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, u konstatua se dokumentet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në disa raste mungojnë e në disa raste janë nënshkruar në grup për 2 apo 3 muaj shërbim mirëmbajtje njëkohësisht, çfarë tregon për një vijimësi formale në ndjekjen e zbatimit të kontratës. Nuk janë raportuar problematika në lidhje me sistemin eGjoba duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë problematikë, megjithëse vetë agjentët e policisë u shprehën se deri në fund të vitit 2023 sistemi ka shfaqur probleme të vazhdueshme.

Nga auditimi mbi raportet e kërkuara sipas specifikimeve teknike në kontratën nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, për filtrimin e të dhënave të populluara elektronikisht, u konstatua se aktualisht nuk janë ndërtuar raporte sipas llojit të shkeljes dhe sipas zonave. Kjo kërkesë e specifikimeve teknike rezulton e paplotësuar aktualisht nga OE.

DTI dhe OE nuk kanë vijuar me ndjekjen e kontratës sipas specifikimeve teknike dhe nuk kanë raportuar mbi problematikat e hasura.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, u konstatua se nuk janë plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara mbi raportimin, që janë:

- Raporti fillestar i prodhuar brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit;
- Draft Raporti Përfundimtar prej maksimumi 20 faqesh i prodhuar deri në 1 muaj para përfundimit të kontratës;
- Raporti final me të njëjtat specifika si Draft Raporti përfundimtar i prodhuar brenda 5 ditësh pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

Nga auditimi mbi funksionet shitesë të parashikuara në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se disa nga kërkesat e specifikimeve teknike **nuk janë realizuar**, të cilat janë:

- Integrimi me 6 pajisjet radar fiks dhe shfaqja e eventeve të këtyre pajisjeve, nuk është realizuar në sistemin eGjoba. Të dhënat e shpejtësisë, targës dhe fotografimi i tij nuk janë ekspozuar në sistemin eGjoba në mënyrë automatike sikurse është kërkuar në rubrikën “Integrimi në eGjoba i 6 radarëve fiks ekzistues”. Moduli i ndërtuar për regjistrimin e gjobave nga Salla e Monitorimit, nuk konsiderohet integrimi i pajisjeve, por është një ndërfaqe e zhvilluar për regjistrimin e kundërvajtjeve nga kjo strukturë operacionale;

- Integrimi me Policinë Bashkiake nuk është bërë nëpërmjet një API sikurse është kërkuar në specifikimet teknike, por me akses të drejtpërdrejtë në sistem;
- Nuk është ndërtuar ndërveprim me eGjopa i sistemit të radarit të montuar në mjetin inteligjent, sikurse është kërkuar në specifikimet teknike;
- Në rastin e targave të huaja nuk është bërë akoma i mundur ekspozimi i informacionit të kundërvajtjeve për sistemin TIMS që gjopa të paguhet në kufi kur mjeti del. Kjo kërkesë është parashikuar në specifikimet teknike në rubrikën “*Integrimi i pajisjeve të matjes së shpejtësisë dhe verifikimit*”.
- Nuk është ndërtuar ndërveprim për marrjen, ruajtjen dhe shfaqjen e informacioneve shtesë për automjetin nga DPSHTRR si ngjyra, fuqia motorike, viti i prodhimit të automjetit.
- Në rubrikën “*Raporte*” për të dy kontratat janë parashikuar raporte mbi të njëjtat kritere, pavarësisht që kontratat e nënshkruara për sistemin eGjopa janë zhvilluar me 4 vite diferencë. Nuk rezultojnë të jenë ndërtuar raporte bazuar në llojin e shkeljes apo sipas vendndodhjes që konsiderohen “Zona” sipas Policisë Rrugore, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar në rubrikën “*Raporte*”. Kjo kërkesë nuk është përmbushur që në kontratën e parë nr. 3921, datë 07.08.2018 dhe ka vijuar të mos jetë plotësuar me kontratën nr. 20, datë 16.08.2022. Implementimi i sistemit “egjopa” Specifikimet teknike të kontratës nr. 20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjopa, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”.

Kërkesat e specifikimeve teknike të cilat nuk janë realizuar në sistemin eGjopa, nuk janë raportuar nga ndjekësit e kontratës përfaqësues të dy institucioneve AKSHI dhe DPPSH, çfarë tregon se ndjekja e kontratës nuk është kryer nga personat e caktuar me këtë detyrë. Mangësitë në realizimin e kontratës, janë përgjegjësi e ndjekësve të kontratës, si dhe OE që ka patur detyrimin për të plotësuar të gjitha kërkesat e dokumentuara në specifikimet teknike në sistemin eGjopa brenda afatit të parashikuar në kontratë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.3, datë 29.03.2024, protokolluar në DPPSH me nr. 685/3 prot., datë 29.03.2024 si dhe trajtuar në faqet 18-34 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

2.3 Auditimi i sistemit informatik të Kundravajtjeve Rrugore mbi të dhënat Input / Output

Në zbatim të pikës 3, është shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemi informatik i Kundravajtjeve Rrugore mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij si:

- Manuali i përdorimit versioni 1.2;
- Manuali i përdorimit për Mobile;
- Manuali i përdorimit për Web;
- Shërbimet e kontraktuara në mirëmbajtje me kontratat nr.3921 prot, datë 07.08.2018 për ngritjen e sistemit si dhe kontrata nr.20 datë 16.08.2022;
- Raporti i Auditimit të këtij sistemi kryer nga njësia e Auditit të Brendshëm;
- Udhëzimet mbi zbatimin e Kodit Rrugor, etj.
- Vendimi nr. 846, datë 7.12.2016 për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të policisë së shtetit për menaxhimin elektronik të gjobave (e-gjopa).

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk ka qenë bashkëpunues në dhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga grupi i auditimit, me justifikimin se nuk kanë patur njerëz të përgjigjen në kohë, pasi nga ky departament kishte largime masive të punonjësve, çfarë tregon për një mungesë të theksuar organizimi në këtë strukturë megjithëse në numër të

lartë punonjësish. Kjo situatë rendoi dhe kohën e audituesve të grupit në të gjitha drejtimet e auditimit.

Nga auditimi mbi manualët e përdorimit për versionin mobile dhe web, u konstatua se:

- Nuk jepen udhëzime mbi hapat që duhet të ndjekë përdoruesi, nëse të dhënat e fjalëkalimit janë vendosur gabim e për pasojë nuk mund të logohet në sistem;
- Nuk jepen kriteret e aplikuara në sistem për fjalëkalimin si informacion udhëzues dhe ndihmës për përdoruesit.

Qëllimi i ndërtimit të sistemit eGjoba ka qenë menaxhimi elektronik i gjobave nëpërmjet automatizimit të procesit të administrimit të gjobave, si dhe përqendrimi i të dhënave të gjobave, për të gjitha njësitë e Policisë Rrugore.

Përshkrim Historik dhe Teknik i zhvillimit të sistemit që ka pësuar gjatë viteve:

Sipas informacionit të dhënë nga departamenti i IT, Policia e Shtetit ka përdorur deri në datën 6 Janar 2024 sistemin e vjetër eGjoba i cili ishte i zhvilluar në teknologjitë:


- Java 7.0
- Vaddin Framework 6.0
- Oracle 11 G

Duke qenë se sistemi i mëparshëm ngrihej mbi teknologji të vjetra, ishte e vështirë dhe ndonjëherë e pamundur për t'u përditësuar dhe zgjeruar në përputhje me nevojat në rritje të Policisë së Shtetit. Për këtë arsye nisi ri-dizenjimi i sistemit eGjoba duke u bazuar në teknologjitë dhe praktikat më të mira të dizenjimit të sistemeve software.

Me ndërtimin e një versioni më të mirë të sistemit eGjoba, janë ri-dizenjuar dhe elementë të tjerë të sistemit, si:

- E-Gjoba Web;
- E-Gjoba Mobile services (web serviset për komunikimin me tabletat);
- Servisi i dërgimit të masave plotësuese drejt DPSHTRR;
- Komunikimi me AMF;
- Komunikimi me DPSHTRR për të dhënat mbi automjetet;
- Web Servisi i pagesave të gjobave i cili përdoret nga institucionet si Posta, bankat , etj;
- Krahas platformës së përdorimit të këtij sistemi, është ri-dizenjuar baza e të dhënave dhe janë migruar të dhënat nga Oracle Db në Sql Server.

DPPSH disponon diagramin e qarkullimit të informacionit nëpërmjet sistemit eGjoba, si në figurën më poshtë:



Shërbimet që ofrohen nga e-Albania për kundërvajtjet rrugore të verbalizuara janë:

- Njoftimi i qytetarëve dhe bizneseve për gjokat e automjeteve të tyre nëpërmjet e-mailit, mesazhit telefonik dhe mesazhit në e-Albania;
- Dërgimi i fletës së gjobës dhe vendimeve të komisionit në hapësirën “Dokumentat e mia në e-Albania”;

Sipas informacionit të vënë në dispozicion, lista e shërbimeve që ofrohen si dhe informacion teknik mbi ndërveprimet me sisteme të tjera të sistemit të Kundërvajtjeve Rrugore, si me:

- Sistemin TIMS Portal, për të mundur autentifikimin në sistem dhe për të marrë të dhënat rreth oficerëve dhe strukturave organizative.
- Sistemin TIMS për të marrë informacion rreth alerteve që ka në këtë sistem, për personat apo automjetet.
- Sistemin DPSHTRR për:
 - Marrjen e informacioneve rreth automjeteve (targat);
 - Marrjen e informacioneve rreth lejeve të drejtimit (patentat);
 - Dërgimin e masave plotësuese të gjobave dhe vendimeve të komisionit.
- Sistemin e-Albania për shfaqjen e kundravajtjeve rrugore dhe për njoftimin e qytetarëve për gjokat e tyre.
- Sistemin TIMS Criminal për të marrë alertet e këtij sistemi rreth mjeteve dhe personave.
- Sistemin e AMF për të marrë informacion rreth policës së sigurimit të automjetit.

Sistemi e-Gjopa ofron shërbim për:

- Policinë e Shtetit pasi të gjitha funksionalitetet e sistemit përdoren nga Policia e Shtetit.
- Policinë Bashkiake, të cilat regjistrojnë kundravajtjet e tyre rrugore në këtë sistem dhe më pas gjenerojnë raporte/statistika.
- E-Albania, me qëllim shfaqjen e kundravajtjeve rrugore dhe njoftimin e qytetarëve për kundravajtjet e tyre rrugore.
- Institucionet që mundësojnë pagesat e gjobave si Posta, Bankat e nivelit të dytë, etj. Këto institucione konsumojnë një web servis i cili i mundëson:
 - Listimin e gjobave të një mjeti;
 - Listimin e informacionit të një gjobe;
 - Pagesën e një gjobe.

Për sa i përket ndërveprimit / komunikimit me sistemet e tjera, jemi informuar se:

- a. Sistemi eGjoba komunikon me TimsPortal, për të autentifikuar përdoruesit dhe për të marrë të dhëna mbi oficerët dhe strukturat ku ata punojnë.
- b. Sistemi eGjoba komunikon me tims-service, për të marrë të dhëna nga regjistri i gjendjes civile (NCR).
- c. Sistemi e-Gjoba komunikon me sistemin tims-service, për të marrë alerte për automjetet dhe personat.
- d. Sistemi e-Gjoba komunikon me sistemin e Menaxhimit të Cështjes (CRIS), për të marrë alertet për personat dhe automjetet.
- e. Sistemi e-Gjoba komunikon me DPSHTRR nëpërmjet servisit EgjobaLdBridge, për të marrë të dhënat e drejtuesve të mjeteve dhe pikët e patentave.
- f. Sistemi e-Gjoba komunikon me DPSHTRR nëpërmjet GG (Government Gateway), për të marrë të dhënat mbi targat dhe automjetet.
- g. Sistemi e-Gjoba komunikon me AMF, për të marrë të dhënat në lidhje me siguracionet e automjeteve.
- h. Sistemi e-Gjoba informon qytetarët dhe bizneset, për gjobat e automjeteve të tyre nëpërmjet servisit eGjobaNotification Service.
 - Ky shërbim përdor servisin egjobaLdBridge dhe eGjoba DPSHTRR Service (GG) për të marrë të dhënat e mjeteve dhe drejtuesve.
 - Ky shërbim përdor shërbimet e ekspozuara në GG për njoftimin e qytetarëve me email, mesazh në telefon dhe mesazh në rubrikën 'Mesazhet e mia' në eAlbania.

Për sa i përket ruajtjes së gjurmëve elektronike, jemi informuar se deri më datë 06.01.2024 është përdorur sistemi e-Gjoba i vjetër, ku janë ruajtur:

- Loge të aplikacionit në serverin web Glass Fish. Këto log-e janë të ruajtura në serverat ku ky sistem ka qenë hostuar;
- Audit të ndryshimeve në nivel data baze. Këto informacione janë të ruajtura në databazën e vjetër të sistemit e-Gjoba;
- Log-e për përdorimin e shërbimit të pagesave. Këto informacione janë të ruajtura në databazën e vjetër të sistemit e-Gjoba.

Me vënien në funksion sistemi i ri e-Gjoba në datën 07.01.2024, ka të dhëna të ruajtura për:

- Log-s të aplikacioneve/serviseve të hostuara në web serverin Tomcat. Këto loge janë në formatin tekst dhe janë të ruajtura në serverat ku sistemi e-Gjoba është i hostuar;
- Auditimin e ndryshimeve në nivel data baze. Këto informacione janë të ruajtura në data bazën aktuale. Për çdo tabelë ka një tabelë auditi e cila ruan çdo ndryshim që behen ne rekordet e data bazës;
- Log-s për përdorimin e shërbimit të pagesave. Këto informacione janë të ruajtura në databazën aktuale;
- Log-s të gabimeve që gjenerohen nga sistemi. Këto informacione janë të ruajtura në data bazën aktuale.

Me VKM nr.846, datë 07.12.2016, është krijuar baza e të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobjave (E-gjoba), me administrim nga Policia e Shtetit. Qëllimi i ndërtimit të këtij sistemi qendror është që të mund të sigurohen për organet përkatëse informacione të saktë dhe të shpejtë mbi:

- a) Gjendjen e gjobjave të një mjeti (paguar/pa paguar), së bashku me të dhënat e mjetit;
- b) Historikun e mjetit dhe të veprimtarisë së plotë të përdoruesit;
- c) Raporte për gjobat, agjentin, vendimet e komisionit, mjetin, operatorët;
- ç) Statistika për gjendjen e gjobjave, performancën e operatorit dhe pasqyrën e rezultateve;
- d) Plotësimin e një gjobe të re me të dhënat e punonjësit që vendos gjobën dhe të dhënat e shkelësit të dispozitave të Kodit Rrugor.

Të dhënat parësore të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) janë të dhënat e gjobës në të cilën vendoset:

- Numri serial i gjobës;
- Koha e vendosjes së gjobës;
- Vendndodhja;
- Vlera e gjobës;
- Shuma;
- Arsyeja e vendosjes së gjobës.

Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga:

- DPSHTRR, si: targa e mjetit, modeli i mjetit, shasia, pronari si dhe të dhënat për lejen e drejtimit dhe historikun e zotëruesit, të dhënat e plota të regjistrimit të mjetit dhe drejtuesit e mjeteve (pronar dhe përdorues);
- Sistemi i RMIS (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Brendshme të Policisë së Shtetit), emër/mbiemër i punonjësit të Policisë që vendos gjobën, funksioni, struktura organizative ku ky punonjës bën pjesë, grada.

Kundravajtjet rrugore konstatohen nga disa drejtime, të cilat janë:

- Nga agjentët e Policisë të cilat regjistrohen në sistem me pajisjet tablet;
- Nga agjentët e Policisë, të cilat regjistrohen në bllok vetëm në rastet kur lidhja me sistemin elektronik eGjoba nëpërmjet pajisjeve tablet është e pamundur;
- Nga pajisjet radar dhe pajisjet inteligjente të Policisë.

Njësia Operacionale për Sigurinë Rrugore dhe Autostradave është strukturë në varësi të Drejtorisë së Policisë Rrugore dhe përdor pajisje inteligjente për kryerjen e detyrave të saj operacionale. Të gjitha kundravajtjet e konstatuara me mjete inteligjente që janë konstatuar dhe shkarkuar, verbalizohen si masa administrative nga struktura e Sallës së Monitorimit të Drejtorisë së Policisë Rrugore, bazuar në rregullat e qarkullimit rrugor.

Gjatë periudhës së auditimit në terren, punonjësit e Sallës së Monitorimit testuan dhe kaluan në sistemin LIVE, ndërfaqen e zhvilluar për regjistrimin e gjobave dhe alerteve bazuar në gjurmë të ruajtura nga pajisjet inteligjente, që përdor Njësia Operacionale për Sigurinë Rrugore në terren. Ky funksionalitet për plotësimin e procesverbalit ka lehtësuar procedurën operacionale të regjistrimit, për të dhënat e kundravajtjeve të konstatuara me mjete inteligjente të cilat më parë regjistroheshin në sistem nga kjo njësi duke përdorur pajisjet Tablet.

Elementët kryesorë që vërtetojnë kundërvajtjen janë: Data, Ora, Vendi. Ndërsa, fotografimi është prova që vërteton tre elementët që përcaktojnë kohën dhe vendin.

Fotografimi nga radari, jep të dhëna mbi targën, orën, datën, shpejtësinë e matur, shpejtësia e korrigjuar, numrin serial të pajisjes, lloji i automjetit, indeksi i vendit, etj.

Në modulën e regjistrimit të të dhënave nga Salla e Monitorimit “Gjobë nga SM”, për kundravajtjet e pajisjeve inteligjente, nuk ruhej asnjë e dhënë e cila është gjeneruar prej fotografimit. Data dhe ora që plotësohen në sistem janë datë regjistrimi dhe orë regjistrimi, të cilat nuk tregojnë kohën e saktë që ka ndodhur kundërvajtja. Pronarët e mjeteve, kur informohen për gjobat nëpërmjet e-Albanias apo bankave te nivelit të dytë, informohen për kundravajtjet të cilat nuk tregojnë kohën reale të shkeljes, çfarë sjell dhe një numër të lartë ankesash e shqyrtimeve të panevojshme.

Gjatë auditimit mbi ndërfaqen e ndërtuar në sistemin eGjoba për regjistrimin e të dhënave të gjeneruara nga radari, u konstatua se nuk populloheshin të dhënat parësore për datën dhe orën kur ka ndodhur kundërvajtja, miratuar me VKM nr.846, datë 07.12.2016.

Data dhe ora e kundravajtjes si të dhëna parësore të këtij sistemi, nuk mund të mungojnë në bazën e të dhënave në asnjë rast të regjistrimit të një kundravajtjet, sikur se ndodhte në regjistrimin e të dhënave nëpërmjet ndërfaqes “Gjobë nga SM”, ku data dhe ora populloheshin si fillim automatikisht me të dhëna të regjistrimit të rekordit në sistem.

Gjatë fazës së auditimit në terren popullimi me të dhënat mbi kohën e saktë të kundërvajtjes, u pranua nga personat përgjegjës të Drejtorisë së Policisë Rrugor të cilët kërkuan dhe ndryshimet në sistem duke regjistruar kohën e saktë të kundërvajtjes dhe jo kohën e ruajtjes së veprimit në sistem.

Nga auditimi mbi ndryshimet e bëra në modulën “Gjobë nga SM” u konstatua se të dhënat e kohës së regjistrimit në sistem do të jenë të rëndësishme për efekt të kontrollit mbi aktivitetin e Sallës së Monitorimit, atëherë nevojiten të shtohen Data dhe Ora e regjistrimit të cilat duhet të popullohen automatikisht me orën e sistemit.

Për regjistrimin e të dhënave të kundërvajtjes së konstatuar me mjete inteligjente është zhvilluar një formë procesverbali për përdoruesin ku të dhënat që plotësohen janë si më poshtë:

Data/Vendi	Data Rruga	Ora Vendi
Shkelësi	Emër mbiemër Nr NNNNNNNNS	Leje drejtimi/kateg.B Adresa
Mjeti	Tipi Targa	Kapaciteti
Pronari	Emër mbiemër (ose subjekti) Adresa	
Shkelja	Ka shkelur ligjin 8378 Neni {140/9, 127/3/1, 198/5} Pezullim i lejedrejtimit të mjetit, Kufizimet e shpejtësisë, Përcaktimi dhe Verbalizimi i Shkeljeve	Datë 22.07.1998
Deklarata e Shkelësit	Deklaroj se	
Deklarata e Agjentit	Deklaroj se VKM 153 dt 07.04.2000 Neni 35 pasi me dt 26.02.2024 në orën 26.02.2024	
Sanksioni	Të gjobitet me 3000 lekë Masë Plotësuese	
	Pagesa bëhet brenda 15 ditëve kur merr formë të prerë. Me kalimin e afatit paguhet 2% kamatë në ditë. Kodi i llogarisë Ekonomike të Kamatëvonesës të jetë 7115500	
	Kodi i Institucionit	Kodi i Degës së Thesarit

Aktualisht në sistemin eGjopa pagesa për kundërvajtjet e mjeteve me targa të huaja të konstatuara me prezencë të drejtuesit, mund të kryhet si pagesë cash tek agjenti. Është agjenti i policisë rrugore që ka detyrimin e depozitimit të tyre në llogaritë përkatëse.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për sistemin eGjopa, u konstatua se nuk janë përcaktuar rregullat mbi administrimin e të dhënave dhe nivelet e aksesimit për të gjithë palët që kanë akses mbi to në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ku DPPSH është krijues, zotërues dhe administrues, ndërsa AKSHI është ofrues i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe sistemit informatik të cilat aktualisht i ka kontraktuar tek Operatori Ekonomik.

Mungesa e ndarjes së përgjegjësisë mbi administrimin e të dhënave me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH mbart riskun e cenimit të integritetit, si dhe plotësisë dhe disponibilitetit të tyre.

Nga auditimi mbi dy procesverbalet e gjeneruara të sistemit eGjopa ku njëri shkruhet në tablet ndërsa tjetri në ndërfaqen e përdoruesit operacional, u konstatuan disa mospërputhje për të njëjtat fusha që janë renditur si më poshtë:

- Nr. Serial quhet nëse regjistrohet në tablet dhe Seria NR quhet e njëjta fushë nëse gjenerohet nga salla e monitorimit.
- Teksti shpjegues në qelizën referuar sanksionit nuk paraqet të njëjtën përmbajtje në të dy procesverbalet.
- Personi që ka kryer kundërvajtjen nëse gjenerohet nga tableti quhet “kundërvajtësi”, ndërsa nga moduli i sallës së monitorimit quhet “Shkelësi”.

- Formati i datës në procesverbalin e gjeneruar nga tableti në formën dd-mm-yyyy ndryshon me formatin e datës të gjeneruar nga moduli ku regjistrohen të dhënat e pajisjeve inteligjente në formën dd.mm.yyyy.
- Të dhënat e mjetit në procesverbalin e gjeneruar nga tableti janë Marka, Targa, Tipi dhe Kapaciteti. Ndërsa të dhënat e gjeneruara nga moduli i sallës operationale janë: Tipi, Targa dhe Kapaciteti.
- Në kategorinë “Shkelja” përcaktohen nenet e shkeljes, por emërtimet e tyre nuk paraqiten në mënyrë respektive sipas radhës së vendosur të neneve, çfarë krijon konfuzion në leximin e shkeljeve dhe referencat ligjore.
- Në procesverbalin e gjeneruar nga tableti për datën dhe vendin, ruhen të dhëna në fushat “Adresa” dhe “Qyteti”. Ndërsa, në procesverbalin e konstatimit të shkeljes të regjistruar në sistem nëpërmjet modulit të ri të njëjtën fushë ruhen të dhëna në fushat “Rruga” dhe “Vendi”. Nga auditimi mbi ndërfaqen e sistemit “Gjobë nga SM” për plotësimin e e kundravajtjeve, në fushën e përcaktuar si “Deklarata e Agjentit” popullimi i saj është një përshkrim i tipit text, në të cilin shënohen data dhe ora kur është gjeneruar fotografimi nga mjetet inteligjente. Si text shënohen gjithashtu të dhënat për nenin, ligjin, aksin rrugor, pikët e zbritura, shpejtësia e fotografuar, si dhe pajisja radar që e ka fotografuar. Emërtime dhe referenca të ndryshme në të dhënat dhe popullimin e gjobave në sistem krijohen nga mungesa e bashkëpunimit të ndjekësve të kontratës që janë specialistë të fushës TIK me strukturat e Policisë Rrugore që kanë nevojë për ndërfaqen e *përdoruesit operacional* “Gjobë nga SM”.

Nga auditimi mbi procesverbalet e konstatimit të shkeljes, u konstatua se fotografimi nuk është bërë pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, miratuar me VKM nr. 42, datë 30.01.2019 “Për disa shtesa në VKM nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave”.

Fotografimi është prova që vërteton shkeljen e konstatuar. Mungesa e kësaj prove në informacionin që i vihet në dispozicion kundërvajtësit nëpërmjet shërbimeve online në eAlbania, bën që të ketë një numër të lartë ankesash në këtë drejtim.

Nga auditimi u konstatua se njoftimi i shkelësit jo prezent për kundërvajtjen duhet të bëhet dhe me shpresë në adresën e tij bazuar në procedurën nr.1719, datë 20.11.2023. Për të realizuar këtë detyrë, punonjësit e policisë që kanë konstatuar dhe regjistruar shkeljen në sistem, detyrohen t’i njoftojnë me shpresë shkelësit që nuk janë konstatuar prezentë. Në shumë raste, kjo procedurë rezulton e paefektshme për shkak të adresave të gabuara apo të paplota në sistemin e adresave, të dhëna këto që lexohen nga regjistri i adresave në DPGJC.

Nga auditimi u konstatuan disa problematika të ndërveprimit të të dhënave me DPSHTRR, të cilat janë:

- Nuk është ndërtuar ndërveprim ndërmjet sistemit eGjoba dhe DPSHTRR, për periudhën e plotë që drejtuesi rezulton i pajisur me leje drejtimi, me qëllim përlllogaritjen për zbritjen e pikëve në rast të një kundravajtjeje. E dhëna që lexohet nëpërmjet web-servisit është data e lëshimit të leje drejtimit, ku në rastet kur ajo është e rinovuar, nuk tregon kohën e plotë që drejtuesi është pajisur me leje drejtimi. Agjenti i policisë nuk ka një mënyrë se si të përlllogarisë zbritjen e pikëve mbi një leje drejtimi në rast se diferenca ndërmjet datës së konstatimit me datën e lëshimit të lejes tregon se ai/ajo është një drejtues i ri ndërkohë që leja e drejtimit është e rinovuar. Vetë punonjësit e policisë rrugore në terren u shprehën se kanë marrë vërejtje për vendosjen e masave plotësuese jo të sakta për këtë arsye;
- Pikët e zbritura nga patenta, për një kundravajtje të caktuar nuk pasqyrohen saktë në sistemin eGjoba ndryshe nga portali e-Albania ku situata mbi pikët e zbritura dhe të shtuara duket e saktë. Kjo tregon se ndërveprimi ndërmjet DPSHTRR-së dhe sistemit eGjoba nuk është ndërtuar në mënyrën e duhur;
- Nuk lexohen elektronikisht të dhënat mbi kontrollin teknik. Ky verifikim aktualisht bëhet vetëm në prezencë të drejtuesit duke parë dhe verifikuar dokumentin fizik të lëshuar nga DPSHTRR;

- DPSHTRR dhe DPPSH nuk kanë aktualisht të ndërtuar një bashkëveprim me qëllim vjeljen e gjobave duke lexuar nga sistemi i eGjoba detyrimin e kundërvajtësit përpara kolaudimit.

Ndërveprimi ndërmjet të dhënave që janë regjistruar si baza të dhënash shtetërore rezulton me mangësi në rastet kur nuk janë ndërtuar bashkëveprime dhe pasaktësi në të dhëna të lexuara nga DPSHTRR kur në sistemin eGjoba rezultojnë ndryshe nga eAlbania.

Nga verifikimi në terren mbi përdorimin e sistemit eGjoba u konstatua se:

- Përveç regjistrimit në sistem, agjentët e policisë rrugore i regjistrojnë kundravajtjet manualisht në një regjistër, ku të dhënat që regjistrohen aty lexohen nga sistemi, ku po të njëjtët punonjës i kanë regjistruar më parë. Ky veprim manual jo vetëm që nuk është efektiv, por rrit fiktivisht ngarkesën e punonjësve;
- Letrën e printerave termikë që e kanë të lidhur me tabletët, agjentët e sigurojnë në mënyrë individuale pasi prej kohësh nuk ka patur gjendje;
- Në disa raste, agjentët shprehën shqetësimin se dhe radiot e komunikimit i sigurojnë po në mënyrë individuale pasi nuk ka patur gjendje. Ky element cenon sigurinë në komunikimin ndërmjet tyre pasi radiot që shiten në treg jo gjithmonë i plotësojnë kriteret e nevojshme për të qenë të sigurt;
- Vetë agjentët tregojnë se pajisjet alkoolmatëse, megjithëse janë të kolauduara, nuk japin të dhëna të afërta me sa konstatohet nga ky verifikim.

Bllokimi i sistemit egjoba në raste të caktuara dhe mungesa e pajisjet të nevojshme për agjentët e policisë rrugore në terren pwrben risk në vendosjen e gjobave të pasakta.

Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit eGjoba për kundravajtjet e konstatuara në mjetet me targa të huaja, u konstatua se:

- Nuk hidhen në sistemin gjoba, në mënyrë që këto të dhëna të jenë të vlefshme për t'u ekspozuar në sistemin TIMS për kontrolle në pikat kufitare. Përcjellja me rrugë shkresore për në pikat kufitare, tregon se lidhja ndërmjet sistemit TIMS dhe eGjoba nuk është bërë për njoftime automatike për këto raste të kundravajtjeve nga mjete me targa të huaja, megjithëse të dy sistemet janë në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Hartimi shkresor i “Njoftimit në kufi” është joefektiv për sa i takon vjeljes së kundravajtjes për arsye se identifikimi i rasteve dhe komunikimi deri në njësitë kufitare bëhet për më shumë se 24 orë;

- Në sistemin eGjoba nuk është ndërtuar një funksionalitet ku agjenti krahas kundravajtjes, të mund të plotësojë dhe arkëtimin duke e regjistruar rekordin në sistem dhe të gjenerojë një faturë arkëtimi sikurse gjeneron dhe printon një faturë kundravajtje, me qëllim ruajtjen e të dhënave në sistem dhe parandalimin e abuzimit në këto raste.

Nuk është ndërtuar në sistem një formë ku të regjistrohen kundravajtjet e mjeteve me targa të huaja me prezencë ose jo duke lwnw jashtw informatizimit të dhënat mbi kundravajtjen të cilat nuk janë informatizuar dhe kanë mbetur jashtë sistemit informatik eGjoba.

Këto veprime aktualisht kryhen duke përdorur bllokun fizik dhe gjithë administrimi i dokumentacionit kryhet manualisht. Këto të dhëna duke mos u regjistruar në sistem, nuk kontrollohen në kohë reale në pikat kufitare me qëllim vjeljen e tyre. Komunikimi me njësitë kufitare është në formë shkresore bazuar në rregulloren e “Njoftim në Kufi” e përditësuar me urdhrin nr.322, datë 14.02.2024. Në këtë dokument renditen mjetet me targa të huaja që kanë kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, të konstatuara pa prezencë të drejtuesit.

Nga auditimi mbi raportet e ndryshme të ndërtuara në sistemin eGjoba u konstatua se nuk janë ndërtuar filtrime të dhënash që të plotësojnë kërkesat e Drejtorisë së Policisë Rrugore, pasi:

- Nuk ka raporte të ndërtuara për filtrime sipas qarkut;

- Nuk ka raporte të ndërtuara për shkeljet me më pak se 5 apo me më shumë se 5, pra të ndryshme nga numri 5. Për numrin e shkeljeve është ndërtuar një raport që ka kushtin që kundravajtjet të jenë aktive në 5 raste;
- Në raportin “*Statistikë sipas neneve*” nuk gjenerohen shkelje sipas neneve, por sipas datave të vendosura si fusha kryesore filtrimi. Të dhënat që nxjerr ky raport nuk eksportohen në excel për analiza të mëtejshme që i nevojiten Drejtorisë së Policisë rrugore bazuar në shkeljet sipas neneve;
- Në excel janë lejuar të eksportohen raporte mbi një person apo një mjet, ndërkohë që analizat që nevojiten të bëhen nga Drejtoria e Policisë Rrugore nuk bazohen në rekorde individuale, por sasiore me të dhëna të plota.

Drejtorja e Policisë Rrugore nuk është përfaqësuar me një punonjës të strukturës së saj që njihet nevojën për llojin dhe përmbajtjen e raporteve që gjenerohen me të dhëna nga sistemi dhe u shërbejnë për analiza të mëtejshme. Raportet aktuale nuk japin mundësi për të analizuar të dhëna sasiore të cilat gjenden në sistem si rezultat i proceseve të informatizuara.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.4, datë 29.03.2024, protokolluar në DPPSH me nr. 685/4 prot., datë 29.03.2024 si dhe trajtuar në faqet 34-43 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

IV. REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesverbalet e konstatimit të shkeljes, u konstatua se fotografimi nuk është bërë pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, miratuar me VKM nr. 42, datë 30.01.2019 “Për disa shtesa në VKM nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave”.

Fotografimi është prova që vërteton shkeljen e konstatuar. Mungesa e kësaj prove në informacionin që i vihet në dispozicion kundërvajtësit nëpërmjet shërbimeve online në eAlbania, bën që të ketë një numër të lartë ankesash në këtë drejtim.

Nga auditimi u konstatua se njoftimi i shkelësit jo prezent për kundërvajtjen duhet të bëhet dhe me shpresë në adresën e tij bazuar në procedurën nr.1719, datë 20.11.2023. Për të realizuar këtë detyrë, punonjësit e policisë që kanë konstatuar dhe regjistruar shkeljen në sistem, detyrohen t’i njoftojnë me shpresë shkelësit që nuk janë konstatuar prezentë. Në shumë raste, kjo procedurë rezulton e paefektshme për shkak të adresave të gabuara apo të paplota në sistemin e adresave, të dhëna këto që lexohen nga regjistri i adresave në DPGJC.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për shtimin e fotos së kundërvajtjes për mjetin e konstatuar pa prezencë të shkelësit e cila aktualisht nuk është pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, me qëllim minimizimin e ankesave, minimizimin e kohës së trajtimit dhe përgjigjes së tyre, nisur nga fakti që fotografimi i shkeljes është një nga provat që vërteton kundërvajtjen.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Në strukturën e miratuar për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit nga një numër total prej 102 punonjësish aktualisht janë 32 pozicione vakante. Strukturat me më shumë vakanca

janë Drejtoria e Sistemeve, Qendra Operative e Sigurisë dhe Drejtoria e Programimit dhe Bazave të të Dhënave.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Audituesit e strukturës së Auditit të Brendshëm kanë zhvilluar auditime në drejtim të teknologjisë së informacionit por me objektiv të kufizuar për arsye të mungesës në strukturë të specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit. Specialistët e fushës për auditimet që ata kanë zhvilluar i kanë marrë përkohësisht nga struktura e teknologjisë së informacionit në DPPSH duke u siguruar që mos të jenë në konflikt me procesin që është objekt auditimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm me punonjës të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Për sistemin eGjoba nuk është hartuar dhe dokumentuar Strategjia e Backup e dedikuar dhe Strategjia e Rikuperimit e dedikuar me elementët që duhet të përfshihen sipas manualit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

- Nuk dokumentohet procesi i hartimit të planit të testimeve, i realizimit të testimeve dhe i rezultateve të dala nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike, si dhe ruajtja e kopjes rezervë në një tjetër ambient.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e Strategjisë së Backup të dedikuar dhe Strategjisë së Rikuperimit të dedikuar. Të dokumentohet procesi i hartimit të planit, realizimit dhe rezultateve të dala nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe për sistemin e kundravajtjeve rrugore eGjoba, me qëllim identifikimin, ndjekjen dhe adresimin e përgjegjësive në drejtim të sigurisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet në drejtim të sigurisë së informacionit mbi sistemin e menaxhimit elektronik të kundravajtjeve Rrugore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- DTI nuk ka dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në sistemin eGjoba gjatë periudhës së audituar. Megjithëse procesi i punës ka vijuar, DTI nuk rezulton të ketë dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar këto ndryshime nga ana e saj. Nuk ka asnjë dokument gjurmueshmërie për ndryshimet e ndodhura ashtu si është e përshkruar edhe në procedurën e ndryshimit.

- Në lidhje me sistemin eGjoba, nuk zhvillohet dokumentimi dhe monitorimi, për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Për periudhën nën auditim problemet dhe incidentet janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe nuk ka një dokumentim të raportimit dhe zgjidhjes së tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për hartimin e procedurave të administrimit të ndryshimeve që kryhen në lidhje me teknologjinë e

informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu të marrë masa për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuara në sistem e rrjedhimisht në të dhëna, si dhe të bëhet dokumentimi dhe monitorimi i incidenteve dhe problemeve nga DTI.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në sistemin eGjoba janë në total 4830 përdorues Aktiv dhe Jo Aktiv nga të cilët:

- Vetëm 117 prej tyre janë jo aktiv nga ku konstatohet se ka përdorues të cilët edhe pse kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të ndryshme kanë ende statusin aktiv në sistem;
- 308 përdorues e kanë fushën START_DATA të pa plotësuar;
- Nga 117 përdorues jo aktiv në sistem vetëm 2 prej tyre e kanë fushën END_DATE të plotësuar;
- 74 përdorues janë me username emër.mbiemërnumër dhe jo sipas formatit standard emër.mbiemër;
- Fushat që përmbajnë userat e sistemit eGjoba nuk janë të detyrueshme për t'u plotësuar për çdo përdorues. Nga verifikimi rezultoi se 169 përdorues nuk kanë të plotësuar të gjitha fushat si 'officer_id', 'forename', 'surname', 'function' etj, por kanë të plotësuar vetëm fushat 'username', 'active' (nga të cilët 6 prej tyre rezultojnë jo aktivë), 'start_date' (nga të cilët 13 janë fusha boshe), 'end_date' (vetëm një username ka datë mbyllje), si dhe është përcaktuar 'rol' për secilin username;
- Nga verifikimi i përdoruesve të sistemit me ata të larguar në periudhën e audituar rezultoi se ka përdorues të cilët nuk ekzistojnë fare në sistem;
- Ka përdorues të cilët janë jo aktiv dhe nuk kanë një datë mbyllje;
- Nga verifikimi rezultoi se ka përdorues të cilët janë me emër dhe mbiemër përsëritës dhe janë shënuar si username në formatin emër.mbiemërnumër;
- Hapja, mbyllja dhe ndryshimet e përdoruesve mbeten të pa monitoruara duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre;
- Përdorues me username 'bashkia.shkoder' që nuk identifikohen se kujt i përkasin, pra nuk lidhet me një përdorues të përvetshëm në mënyrë që të mbikëqyret se cili person e përdor;
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjellë risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve;
- Nga verifikimi rezultoi se fusha Function nuk është e njëjta për funksione të njëjta që kryhen në sistemin eGjoba.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të marrin masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjjobave, të plotësoj të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrole për mbylljen e tyre në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara, të marrë masa për rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuar nga grupi i auditimit në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemit eGjoba.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është hartuar një rregullore ose dokument mbi parametrizimin e fjalëkalimeve që të përcaktojë përmbajtjen, gjatësinë, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim etj. Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për dokumentimin e politikave të sigurisë për përdoruesit e sistemit si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, kriteri i veçantë nr. 2, pika a), “*të paktën 1 specialist të certifikuar për menaxhim projektesh, PRINCE 2 ose ekuivalent*” është i panevojshëm, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, si dhe cenon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë. Certifikata për menaxhim projektesh (PRINCE 2 ose ekuivalent) shërben për menaxhimin efektiv të një projekti, duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit. Mirëmbajtja dhe vendosja e pjesëve për pajisjet e rrjetit LAN nuk është një projekt, por një procedurë e zakonshme prokurimi malli/shërbimi. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.a faqet 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe personat e autorizuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese të veçanta, të respektojnë legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse në fushën e prokurimit publik duke mos vendosur kriteret të veçanta të panevojshme, për të garantuar një pjesëmarrje të gjerë dhe jo diskriminuese të operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se kriteret e veçanta nr. 2 dhe 3 mbi kapacitetin teknik nuk janë të argumentuara teknikisht, por vetëm ligjërisht, në kundërshtim kjo me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.a faqet 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe Specialisti i fushës të marrin masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të kryhet argumentimi ligjor dhe teknik i të gjitha kriterëve të vendosura, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit me objekt, përkatësisht, “Instalim kabineti Outdoor”, viti 2023; “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverësh dhe sallat e IT-së”, viti 2022; “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.a faqet 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, si dhe personat e autorizuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrin masa që për procedurat e prokurimit publik që do të zhvillohen në vijimësi të mbajnë parasysh të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore procedurale përkatëse, duke mbikëqyrur rigorozisht zbatimin e kontratës për ofrimin e një malli apo shërbimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentet e vëna në dispozicion për ndjekjen e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, për periudhën 2018-2022, si dhe kontratën nr.20, datë 16.08.2022, për periudhën 2022-2023, u konstatua se DPPSH nuk është përfaqësuar me asnjë punonjës të Drejtorisë së Policisë Rrugore në cilësinë e përfituesit të shërbimit, por është përfaqësuar në ndjekjen e kontratës me një punonjës nga struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Asnjë nga specialistët e caktuar si ndjekës kontrate prej dy institucioneve AKSHI dhe DPPSH nuk është njohës i proceseve operacionale në Drejtorinë e Policisë Rrugore, që realizohen nëpërmjet sistemit eGjoba.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.b faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcaktojë si ndjekës të kontratës aktuale nr. 20, datë 16.08.2022 për këtë sistem, specialist të Drejtorisë së Policisë Rrugore që njohin proceset e punës dhe monitorojnë proceset e informatizuara në nivel qendror.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, për zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, u konstatua se dokumentet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në disa raste mungojnë e në disa raste janë nënshkruar në grup për 2 apo 3 muaj shërbim mirëmbajtje njëkohësisht, çfarë tregon për një vijimësi formale në ndjekjen e zbatimit të kontratës. Nuk janë raportuar problematika në lidhje me sistemin eGjoba duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë problematikë, megjithëse vetë agjentët e policisë u shprehën se deri në fund të vitit 2023 sistemi ka shfaqur probleme të vazhdueshme.

Nga auditimi mbi raportet e kërkuara sipas specifikimeve teknike në kontratën nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, për filtrimin e të dhënave të populluara elektronikisht, u konstatua se aktualisht nuk janë ndërtuar raporte sipas llojit të shkeljes dhe sipas zonave. Kjo kërkesë e specifikimeve teknike rezultoi e paplotësuar aktualisht nga OE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.b faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, në mungesë të punonjësve që kanë vepruar si ndjekës të kontratave të sistemit eGjoba, të ngrejë një grup specialistësh me qëllim verifikimin e çështjeve që nuk janë realizuar në kontratën e parë nga OE, i cili është aktualisht i kontraktuar dhe për kontratën aktuale. Mangësitë të përcillen tek AKSHI si Autoritet Kontraktues për sistemin eGjoba dhe përmirësimin e tij.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, u konstatua se nuk janë plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara mbi raportimin, që janë:

- Raporti fillestar i prodhuar brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit;
- Draft Raporti Përfundimtar prej maksimumi 20 faqesh i prodhuar deri në 1 muaj para përfundimit të kontratës;
- Raporti final me të njëjtat specifika si Draft Raporti përfundimtar i prodhuar brenda 5 ditësh pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

*Nga auditimi mbi funksionet shitesë të parashikuara në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se disa nga kërkesat e specifikimeve teknike **nuk janë realizuar**, të cilat janë:*

- Integrimi me 6 pajisjet radar fiks dhe shfaqja e eventeve të këtyre pajisjeve, nuk është realizuar në sistemin eGjoba. Të dhënat e shpejtësisë, targës dhe fotografimi i tij nuk janë eksponuar në sistemin eGjoba në mënyrë automatike sikurse është kërkuar në rubrikën “Integrimi në eGjoba i 6 radarëve fiks ekzistues”. Moduli i ndërtuar për regjistrimin e gjobave nga Salla e Monitorimit, nuk konsiderohet integrimi i pajisjeve, por është një ndërfaqe e zhvilluar

për regjistrimin e kundërvajtjeve nga kjo strukturë operacionale;

- Integrimi me Policinë Bashkiake nuk është bërë nëpërmjet një API sikurse është kërkuar në specifikimet teknike, por me akses të drejtpërdrejtë në sistem;

- Nuk është ndërtuar ndërveprim me eGjopa i sistemit të radarit të montuar në mjetin inteligjent, sikurse është kërkuar në specifikimet teknike;

- Në rastin e targave të huaja nuk është bërë akoma i mundur ekspozimi i informacionit të kundërvajtjeve për sistemin TIMS që gjopa të paguhet në kufi kur mjeti del. Kjo kërkesë është parashikuar në specifikimet teknike në rubrikën “*Integrimi i pajisjeve të matjes së shpejtësisë dhe verifikimit*”.

- Nuk është ndërtuar ndërveprim për marrjen, ruajtjen dhe shfaqjen e informacioneve shtesë për automjetin nga DPSHTRR si ngjyra, fuqia motorike, viti i prodhimit të automjetit.

- Në rubrikën “*Raporte*” për të dy kontratat janë parashikuar raporte mbi të njëjtat kritere, pavarësisht që kontratat e nënshkruara për sistemin eGjopa janë zhvilluar me 4 vite diferencë. Nuk rezultojnë të jenë ndërtuar raporte bazuar në llojin e shkeljes apo sipas vendndodhjes që konsiderohen “Zona” sipas Policisë Rrugore, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar në rubrikën “*Raporte*”. Kjo kërkesë nuk është përmbushur që në kontratën e parë nr. 3921, datë 07.08.2018 dhe ka vijuar të mos jetë plotësuar me kontratën nr. 20, datë 16.08.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.b 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjopa, të përcjellë tek AKSHI si Autoritet Kontraktues, mangësitë në zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit eGjopa në zbatim të kontratës nr.20, datë 16.08.2022, të cilat jo vetëm nuk janë realizuar, por kanë penguar veprimet operacionale të nevojshme për Drejtorinë e Policisë Rrugore Drejtorisë së Policisë Rrugore.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për sistemin eGjopa, u konstatua se nuk janë përcaktuar rregullat mbi administrimin e të dhënave dhe nivelet e aksesimit për të gjithë palët që kanë akses mbi to në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ku DPPSH është krijuar, zotëruar dhe administrues, ndërsa AKSHI është ofruar i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe sistemit informatik të cilat aktualisht i ka kontraktuar tek Operatori Ekonomik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si institucion krijuar dhe administrues i të dhënave që ruhen në sistemin eGjopa, të marrë masa për hartimin e procedurave, organizimin dhe funksionimin e brendshëm si dhe përcaktimin e niveleve të aksesimit në këto të dhëna, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dy procesverbalet e gjeneruara të sistemit eGjopa ku njëri shkruhet në tablet, ndërsa tjetri në ndërfaqen e përdoruesit operacional, u konstatuan disa mospërputhje për të njëjtat fusha që janë renditur si më poshtë:

- Nr. Serial quhet nëse regjistrohet në tablet dhe Seria NR quhet e njëjta fushë nëse gjenerohet nga salla e monitorimit.

- Teksti shpjegues në qelizën referuar sanksionit nuk paraqet të njëjtën përmbajtje në të dy procesverbalet.

- Personi që ka kryer kundërvajtjen nëse gjenerohet nga tableti quhet “kundërvajtësi”, ndërsa nga moduli i sallës së monitorimit quhet “Shkelësi”.

- Format i datës në procesverbalin e gjeneruar nga tableti në formën dd-mm-yyyy ndryshon me formatin e datës të gjeneruar nga moduli ku regjistrohen të dhënat e pajisjeve inteligjente në formën dd.mm.yyyy.

- Të dhënat e mjetit në procesverbalin e gjeneruar nga tableti janë Marka, Targa, Tipi dhe Kapaciteti. Ndërsa të dhënat e gjeneruara nga moduli i sallës operationale janë: Tipi, Targa dhe Kapaciteti.

- Në kategorinë “Shkelja” përcaktohen nenet e shkeljes, por emërtimet e tyre nuk paraqiten në mënyrë respektive sipas radhës së vendosur të neneve, çfarë krijon konfuzion në leximin e shkeljeve dhe referencat ligjore.

- Në procesverbalin e gjeneruar nga tableti për datën dhe vendin, ruhen të dhëna në fushat “Adresa” dhe “Qyteti”. Ndërsa, në procesverbalin e konstatimit të shkeljes të regjistruar në sistem nëpërmjet modulit të ri të njëjtën fushë ruhen të dhëna në fushat “Rruga” dhe “Vendi”. Nga auditimi mbi ndërfaqen e sistemit “Gjobë nga SM” për plotësimin e kundravajtjeve, në fushën e përcaktuar si “Deklarata e Agjentit” popullimi i saj është një përshkrim i tipit “text”, në të cilin shënohen data dhe ora kur është gjeneruar fotografimi nga mjetet inteligjente. Si text shënohen gjithashtu të dhënat për nenin, ligjin, aksin rrugor, pikët e zbritura, shpejtësia e fotografuar, si dhe pajisja radar që e ka fotografuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me Drejtorinë e Policisë Rrugore të marrin masa për unifikimin e të dhënave të ndryshme të evidentuara në procesverbalet që gjenerohen nga i njëjti sistem, por nga ndërfaqe përdorimi të ndryshme që gjenerohen nga agjentët nëpërmjet pajisjeve tablet dhe ndërfaqja në përdorim të zyrës operationale.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan disa problematika të ndërveprimit të të dhënave me DPSHTRR, të cilat janë:

- Nuk është ndërtuar ndërveprim ndërmjet sistemit eGjoba dhe DPSHTRR, për periudhën e plotë që drejtuesi rezulton i pajisur me leje drejtimi, me qëllim përlllogaritjen për zbritjen e pikëve në rast të një kundra vajtjeje. E dhëna që lexohet nëpërmjet web-servisit është data e lëshimit të leje drejtimit, ku në rastet kur ajo është e rinovuar, nuk tregon kohën e plotë që drejtuesi është pajisur me leje drejtimi. Agjenti i policisë nuk ka një mënyrë se si të përlllogarisë zbritjen e pikëve mbi një leje drejtimi në rast se diferenca ndërmjet datës së konstatimit me datën e lëshimit të lejes tregon se ai/ajo është një drejtues i ri ndërkohë që leja e drejtimit është e rinovuar. Vetë punonjësit e policisë rrugore në terren u shprehën se kanë marrë vërejtje për vendosjen e masave plotësuese jo të sakta për këtë arsye;

- Pikët e zbritura nga patenta, për një kundravajtje të caktuar nuk pasqyrohen saktë në sistemin eGjoba ndryshe nga portali e_Albania ku situata mbi pikët e zbritura dhe të shtuara duket e saktë. Kjo tregon se ndërveprimi ndërmjet DPSHTRR-së dhe sistemit eGjoba nuk është ndërtuar në mënyrën e duhur;

- Nuk lexohen elektronikisht të dhënat mbi kontrollin teknik. Ky verifikim aktualisht bëhet vetëm në prezencë të drejtuesit duke parë dhe verifikuar dokumentin fizik të lëshuar nga DPSHTRR;

- DPSHTRR dhe DPPSH nuk kanë aktualisht të ndërtuar një bashkëveprim me qëllim vjeljen e gjobave duke lexuar nga sistemi i eGjoba detyrimin e kundërvajtësit përpara kolauditimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të përcjellë për zgjidhje tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit problematikat që janë evidentuar nga auditimi dhe vijnë si rezultat i mangësisë apo parregullsisë së ndërtuar si ndërveprim ndërmjet bazës së të dhënave të sistemit eGjoba dhe bazës së të dhënave të mjeteve nën administrimin e DPSHTRR-s.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren mbi përdorimin e sistemit eGjoba u konstatua se:

- Përveç regjistrimit në sistem, agjentët e policisë rrugore i regjistrojnë kundravajtjet manualisht në një regjistër, ku të dhënat që regjistrohen aty lexohen nga sistemi, ku po të njëjtët punonjës i

kanë regjistruar më parë. Ky veprim manual jo vetëm që nuk është efektiv, por rrit fiktivisht ngarkesën e punonjësve;

- Letrën e printerave termikë që e kanë të lidhur me tabletët, agjentët e sigurojnë në mënyrë individuale pasi prej kohësh nuk ka patur gjendje;

- Në disa raste, agjentët shprehën shqetësimin se dhe radiot e komunikimit i sigurojnë po në mënyrë individuale pasi nuk ka patur gjendje. Ky element cenon sigurinë në komunikimin ndërmjet tyre pasi radiot që shiten në treg jo gjithmonë i plotësojnë kriteret e nevojshme për të qenë të sigurta;

- Vetë agjentët shprehen se pajisjet alkoolmatëse, megjithëse janë të kolauduara, nuk japin të dhëna të afërta me sa konstatohet nga ky verifikim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Drejtoria e Policisë Rrugore të marrë masa për të shmangur veprime manuale joefektive të agjentëve të policisë rrugore për të dhëna që gjenden të regjistruara në sistemin eGjoba. Gjithashtu, të merren masa për pajisjen e tyre me elementët e nevojshëm si letër printeri, bateri, etj për përdorimin e pajisjeve regjistruese të kundravajtjeve në terren me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes dhe veprimet në sistem.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit eGjoba për kundravajtjet e konstatuara në mjetet me targa të huaja, u konstatua se:

- Nuk hidhen në sistemin gjoba, në mënyrë që këto të dhëna të jenë të vlefshme për t'u ekspozuar në sistemin TIMS për kontrole në pikat kufitare. Përcjellja me rrugë shkresore për në pikat kufitare, tregon se lidhja ndërmjet sistemit TIMS dhe eGjoba nuk është bërë për njoftime automatike për këto raste të kundravajtjeve nga mjete me targa të huaja, megjithëse të dy sistemet janë në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Hartimi shkresor i "Njoftimit në kufi" është joefektiv për sa i takon vjeljes së kundravajtjes për arsye se identifikimi i rasteve dhe komunikimi deri në njësitë kufitare bëhet për më shumë se 24 orë;

- Në sistemin eGjoba nuk është ndërtuar një funksionalitet ku agjenti krahas kundravajtjes, të mund të plotësojë dhe arkëtimin duke e regjistruar rekordin në sistem dhe të gjenerojë një faturë arkëtimi sikurse gjeneron dhe printon një faturë kundravajtje, me qëllim ruajtjen e të dhënave në sistem dhe parandalimin e abuzimit në këto raste.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI procesin që nuk është realizuar nga OE për mundësimin e regjistrimit të të dhënave të kundravajtjes në sistemin eGjoba në mënyrë që këto të dhëna të jenë të ekspozueshme për sistemin TIMS.

Menjëherë

17.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI, nevojën për të regjistruar në sistem arkëtimin e vlerës së kundravajtjes së kryer nga mjete me targa të huaja, si në një proces që aktualisht ka mbetur jashtë informatizimit dhe administrohet manualisht në bllok fizik nga agjenti.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e ndryshme të ndërtuara në sistemin eGjoba, u konstatua se nuk janë ndërtuar filtrime të dhënash që të plotësojnë kërkesat e Drejtorisë së Policisë Rrugore, pasi:

- Nuk ka raporte të ndërtuara për filtrime sipas qarkut;

- Nuk ka raporte të ndërtuara për shkeljet me më pak se 5 apo me më shumë se 5, pra të ndryshme nga numri 5. Për numrin e shkeljeve është ndërtuar një raport që ka kushtin që kundravajtjet të jenë aktive në 5 raste;

- Në raportin “Statistikë sipas neneve” nuk gjenerohen shkelje sipas neneve, por sipas datave të vendosura si fusha kryesore filtrimi. Të dhënat që nxjerr ky raport nuk eksportohen në excel për analiza të mëtejshme që i nevojiten Drejtorisë së Policisë rrugore bazuar në shkeljet sipas neneve;

- Në excel janë lejuar të eksportohen raporte mbi një person apo një mjet, ndërkohë që analizat që nevojiten të bëhen nga Drejtoria e Policisë Rrugore nuk bazohen në rekorde individuale, por sasiore me të dhëna të plota.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 29-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI mangësitë dhe jo efikasitetin e evidentuar gjatë auditimit si dhe nga puna e tyre në vazhdimësi, në raportet që janë ndërtuar në sistemin eGjoba. Mungesa e larmshmërisë së raporteve në përputhje me kërkesat e Drejtorisë së Policisë Rrugore, pengon analiza të mëtejshme për vendimmarrje, vlerësime dhe nevoja të ndryshme që Autoriteti Përfitues ka nevojë.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT